



APPA

Albanian Platform for Policy Advocacy

Ekipi

BULETIN MAJ 2016

Adela DANAJ
Blerina LLALLA
Brenton KOTORRI
Elena PICI
Endrit KAPAJ
Ergisa BEJKOLLARI
Ingrid XHAFA
Flutura GJANA
Gerion TRESKA
Marcela TRINGAJ
Megi LLUBANI
Mimi BARUSHI
Mirilda TILI
Rezarta CAUSHAJ
Rigels XHEMOLLARI
Sokol KONDI

*Faktet, analizat dhe qëndrimet e publikuara nga APPA,
nuk shprehin opinionin e partnerëve tanë.

KRYEMINISTRIA

Mirilda TILI, BA

1. Të ballafaqohesh me veten

Muaji maj prodhoi shumë lajme nga kreu i qeverisë. Kjo jo vetëm sepse aty u "punua" fort për këtë muaj, por për faktin se qeverisja aktuale ka një dashuri të pa limite mbi marrëdhëniet me publikun apo edhe marketingun. Tashmë kanë kaluar 3 vjet na koha kur qeveria Rama ka marrë detyrën dhe shprehjes "fajin e ka Saliu" duket se as ata që e përdorin nuk i besojnë më. Por e thënë në një mënyrë më të thjeshtëzuar tashmë kemi një përballje me veten. Në këtë raport do të kemi një ballafaqim të programit që Partia Socialiste hyri në garën e zgjedhjeve në vitin 2013 dhe sipas tyre siguruan 1 milion vota për kundërshtarit e tyre.

a) Kthimi dhe kompensimi i pronave

Shqiptarët do të jenë të gjithë pronarë të ligjshëm në prona të ligjshme.¹

"Zhdukim 3 zarfet e hallkave të korrupsionit: zarfin tek kthimi i pronave, zarfin tek legalizimet dhe zarfin tek regjistrimi i pronës". Sot pas 3 vjetësh po vetë kryeministri Edi Rama ka deklaruar se: "Sa për dijeni, kjo qeveri dhe kjo shumicë qeverisëse kanë venë në dispozicion të pronarëve dhe të zgjidhjes së problemit 500 milionë dollarë për 10 vitet e ardhshme dhe vetëm në buxhetin e këtij viti janë 30 milionë dollarë. Shuma më e madhe me herë e krahasuar me çdo vit buxhetor në 20 e kusur vite lidhur me

pronarët edhe pronat".² Ndërkohë që Gjykata e të Drejtave të Njeriut me seli në Strasburg të Francës vetme në vendimin e fundit ka detyruar qeverinë shqiptare të dëmshpërbleje në vlerën e 5.3 milionë euro 12 pronarë tokash. Ndaj edhe lind pyetja nëse buxheti i miratuar për 10 vjet do të zgjidhë problemet e pronës apo do të shkojë për të shlyer borxhet e vendimeve të gjykatave?

"Përparësi kompensimit në natyrë, në raport me dhënien e kompensimit financiar, duke mundësuar uljen e faturës financiare për shtetin. Orientim i procesit të privatizimit të pasurive publike me qëllim favorizimin e procesit të kthim-kompensimit të pronave". Këtij qëllimi të fushatës elektorale vetë kryeministri i është përgjigjur në fjalimin e datës 12 maj të këtij viti: "Shqipëria nuk e ka luksin të vazhdojë t'ju thotë pronarëve "Ju do t'i merrni të gjitha pronat mbrapsht" apo që të vazhdojë me historitë e kompensimeve, e pseudo-kompensimeve fizike që janë bërë një fushë spekulimesh dhe korrupsioni e pashoqe. Sa për dijeni, kemi arritur në pikën ku pronat e pretenduara janë dyfishi i sipërfaqes së Republikës së Shqipërisë. Shqipëria ka 28 mijë km katrorë, pretendohet 50 e ca mijë kilometra katrorë pronë, ku janë? Ku? Ndërkohë përditë ndeshemi me mijërat e hektarëve të marra padrejtësisht, të grabitura në emër të kthimit të pronës dhe të kompensimit të pronës. Prandaj, ju siguroj që çdo kritikizëm që i bëhet ligjit të pronës nga pozitat e pronarëve, nga pozita ekstreme gjoja në mbrojtje të pronarëve, - që i kanë lënë pronarët me gisht në gojë ndërkohë që pronat i morën ata që nuk kanë qenë

¹ Programi për kthim, kompensim, legalizimi i pronave <http://ps.al/neë/programi/rimekembje-e-ekonomise/ekonomi-prodhuese-dhe-sherbime/zgjidhje-per-pronat/>

² Pjesë nga fjalimi mbi pronat në Parlament <http://www.kryeministria.al/al/neësroom/fjalime/ligji-i-pronave-500-milione-dollarë-per-10-vitet-e-ardhshme&page=1>

kurrë pronarë, - apo nga pozitat e ekstremit tjetër janë ndoshta interesante për të bërë muhabet në kafenenë e fshatit këtu në këtë sallë por nuk kanë lidhje fare me zgjidhjen praktike të këtij problemi kaq të madh”.³ Edhe në këtë rast komunikimi i bërë nga foltorja e Parlamentit duket sikur bëhet nga pozitat e opozitës, pra diskutohet që ka një problem të madh, por që zgjidhja është e largët.

"I japim fund zvarritjeve dhe sorollatjeve administrative, si burimi bazë i korrupsionit." Në këtë pikë vlen të përgëzohet nisma për t'i dhënë zgjidhje problemit nëpërmjet aplikimit online apo edhe krijimin e një zyre të vetme, pa u dashur të ketë një liste të gjatë institucionesh që janë përgjegjëse dhe rrjedhimisht edhe një kohë shumë e zgjatur, zvarritur, për të marrë përgjigje apo certifikata përkatëse.

"Evidentim i të gjithë pronave publike që fshihen nëpër sirtarët e institucioneve shtetërore. Saktësim i fondit të kompensimit, i cili do të operojë sipas një skeme të qartë dhe të barabartë për të gjithë të interesuarit." Edhe pse deklarohet nga ana e qeverisë se po punohet në këtë pikë, ende nuk ka asnjë përgjigje konkrete se sa është në të vërtetë vlera e kompensimit apo edhe e pronave të cilat duhen kompensuar.

"Legalizim brenda 2 vjetësh i ndërtimeve informale, të bëra në pronën vetjake dhe atë publike. Legalizim i ndërtimeve informale të kryera mbi toka me pronarë dhe të ndërtimeve të kryera në zona urbane, deri në fund të mandatit të parë." Rezultati i deritanishëm është 45 mijë

³ Pjesë nga fjalimi në Parlament mbi ligjin e pronave <http://www.kryeministria.al/al/neesroom/fjalime/ligji-i-pronave-500-milione-dollare-per-10-vitet-e-ardhshme&page=1>

objekte të legalizuara. "Vendosim të shtojmë me 300 punonjës me kontratë, numrin e punonjësve të Agjencisë së Legalizimeve dhe Urbanizimit të Zonave Informale, ALUIZNI. Reforma, shumë e zvarritur në vite, tani ka marrë një shpejtësi tjetër. Kujtoj 45 mijë legalizime të realizuara deri më tani, krahasuar me 21 mijë të kryera nga qeveria e kaluar".⁴

"Zbatim i një programi të veçantë për regjistrimin e Pronave në Bregdetin e Jugut". Për këtë pikë të programit nuk ka ende një strategji të plotë dhe as program, përveç faktit që vazhdon të jetë një zonë edhe më e ndjeshme për shkak të problematikës që mbart. Por ka dhe raste kur surprizat janë aq të pakëndshme sa kupton që zaptimi i hapësirave publike bëhet legjitime.⁵ Edhe në këtë rast sikur të mos mjaftonte problematika që shoqëron pronat publike dhe private në vend si dhe cilësia e turizmit, por edhe urdhri për largimin e plazheve publike mungonte.

2. Rritja ekonomike në vend, ëndërr me sy hapur

Duke iu referuar sërish programit që qeveria Rama ka pasur dhe atyre që vetë kjo qeveri ka deklaruar në këto tre vjet të qeverisjes së saj, kemi sërish një hendek të madh, nga e thëna në të bërë. Më poshtë është lista e plotë e zotimeve për sa i përket zhvillimit ekonomik, uljes së borxhit publik dhe përmirësim të sistemit fiskal. *"Krijim i një programi që synon uljen graduale të borxhit nëpërmjet kontrollit të rreptë të deficitit fiskal në bashkëpunim të ngushtë me FMN dhe BB. Borxh publik në*

⁴ Pjesë nga fjala e zëvendëskryeministrit Niko Peleshi <http://www.kryeministria.al/al/neesroom/lajme/300-vende-te-reja-pune-tek-aluizni>

⁵ Zhdukja e plazheve publike <http://opinion.al/skandali-qeveria-zhduk-zyrtarisht-plazhet-publike/>

parametra të kontrollueshëm dhe jo barrë për brezat e ardhshëm. Borxh publik në parametra të përshtatshëm për ritme pozitive të rritjes dhe strukturën ekonomike të vendit. Politika fiskale që sigurojnë burime financiare gjithnjë në rritje, duke siguruar funksionimin e shtetit në përputhje me proceset integruese. Hapa seriozë për shlyerjen e pjesës më të shtrenjtë të borxhit ekzistues. Shtet që shpenzon paratë me efikasitet dhe efektivitet. Politikat fiskale që prodhojnë më shumë qëndrueshmëri fiskale. Rritje e të ardhurave buxhetore nëpërmjet miradministrimit fiskal dhe uljes së evazionit fiskal. Rritje e të ardhurave buxhetore pa u bazuar në rritjen e nivelit të taksave. Mundësim i një frymëmarrjeje më të madhe për shpenzimet produktive dhe investimet që sjellin punësim dhe rritje ekonomike. Përmirësim i menaxhimit të shpenzimeve publike me synim minimizimin e shpenzimeve joproduktive.”⁶

Borxhi publik është rritur madje jashtë pritshmërie të programit që fitoi zgjedhjet. Aktualisht borxhi publik është rreth 3.75 milionë lekë për frymë. “Borxhi publik për frymë gjatë këtij viti pritet të arrijë në rreth 3.75 milionë lekë për çdo shqiptar. Sipas Ministrisë së Financave, borxhi për frymë këtë vit do të rritet me rreth 4.4% krahasuar me vitin 2015. Ndonëse në terma realë viti 2016 pritet të sjellë një ulje të borxhit në 71.3% të PBB-së, barra virtuale e borxhit nominal për frymë do të rritet edhe këtë vit. Sipas të dhënave më të fundit zyrtare të Ministrisë së Financave, në fund të Shtatorit 2015 ishte një trilion e 63 miliardë lekë ose rreth 73.7% e Prodhimit të Brendshëm Bruto. Në fund të vitit 2016, stoku i borxhit publik pritet të arrijë në afro 1.1 trilionë lekë, një rekord historik. Për këtë vit, qeveria synon të fillojë një kthesë

⁶ Programi qeverisës <http://ps.al/neë/programi/borxh-nen-kontroll>

drejt uljes së borxhit publik, duke e shkurtuar deficitin buxhetor në 2.8% të PBB, nga rreth 4% që ishte vitin e kaluar”- ky është raportimi që ka bërë televizioni SCAN për sa i përket situatës së borxhit publik.

Ndërsa për pjesën tjetër të premtimeve mbi përmirësimin e politikave publike dhe përmirësimin të mjedisit për biznesin apo rritjen ekonomike, ne do të pasqyrojmë kërkesën e përsëritur të FMN-së.⁷ FMN ripërsërit mesazhet për dhënien e PPP-ve vetëm pas një analize kosto-përfitime, mos lejimin e përjashtimeve tatimore dhe vazhdimin e reformave strukturore, me qëllim përmirësimin e konkureshmërinë së biznesit...

Më 27 maj 2016, Bordi Ekzekutiv i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) përfundoi shqyrtimin e shtatë të performancës ekonomike të Shqipërisë në kuadrin e një programi të mekanizmit mbështetës (EFF). Përfundimi i rishikimit u mundëson autoriteteve të tërheqin një shumë shtesë prej 28,65 milion SDR (rreth 36.1 milion €), duke e çuar tërheqjen totale në 209,49 milion SDR (rreth 263.700.000 €). Zëvendës Drejtor Menaxhues i parë dhe Kryetar i Përkohshëm, Z. David Lipton i ka dhënë përgjigje kryeministrit Edi Rama. “Rimëkëmbja ekonomike e Shqipërisë po përshpejtohet. Perspektiva afatmesme mbetet e favorshme, nëse vrulli i reformës do të ruhet. Angazhimet e autoriteteve për zbatimin e reformave strukturore dhe fiskale ambicioze dhe të vështira janë të lavdërueshme. Megjithatë, disa reforma të tjera kritike për përmirësimin e mjedisit të biznesit kanë mbetur mbrapa. Angazhimi i autoriteteve për të vazhduar me

⁷ Raporti i FMN-së <http://www.monitor.al/fmn-shqiperia-te-beje-reforma-ge-te-permiresoje-klime-e-biznesit-levrohet-kesti-36-1-mln-euro/>

konsolidimin fiskal është i rëndësishëm, për të vazhduar uljen e dobësive fiskale dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e borxhit. Planet e autoriteteve për të vazhduar përpjekjet e tyre rregulluese fiskale në anën e të ardhurave janë të përshtatshme. Strategjia e konsolidimit duhet të synojë zgjerimin e bazës tatimore, duke kufizuar përjashtimet nga taksat dhe forcimin e pajtueshmërisë dhe administrimit të të ardhurave"- është shprehur Lipton. Pra kjo mbështetje për të shtuar taksat dhe për të minimizuar numrin e atyre që përjashtohen nga taksat, duket edhe si një thikë pabesie për qeverinë. Ajo është e majtë dhe si e tillë duhet të ulë taksat dhe të ketë përjashtime nga sistemi fiskal, çka bie ndesh me shtyllën e mendimit qeverisës.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Rigels XHEMOLLARI, MSc

1-Reforma në arsimin e lartë, MAS shkelje ligji nga "paaftësia"

¹ Ky afat ka rreth 2 muaj që ka kaluar dhe ende nuk ka dalë asnjë akt i vetëm nënligjor, udhëzim apo VKM. Pra jemi para faktit që një ministri dhe një qeveri pompon çdo ditë në media dhe auditorë si sukses reformën në arsimin e lartë dhe nuk është ulur një ditë të vetme të shohë afatet, aktet dhe nevojën e përsheptimit të procesit. Kur dëshira nuk të përputhet me arritjen, ky fenomen trajtohet si paaftësi, prandaj mungesa e një kolone aktesh nënligjore dhe papërgjegjshmëria institucionale kanë bllokuar një seri procesesh të rëndësishme për zhvillimin e arsimit të lartë.

Duke nisur nga VKM për krijimin e Bordit të Administrimit, për çlirimin e doktoraturave pas një pauze 3-vjeçare, për modelin dhe Agjencinë e Financimit të arsimit të lartë, e deri te kodi i cilësisë së arsimit të lartë janë rreth 30 akte nënligjore që duhet të ishin nxjerrë sipas afateve që përcakton ligji nga Këshilli i Ministrave. Kjo anomali dëmton procesin, arsimin dhe dështimin e ndërtimit në kohë të institucioneve të parashikuara në ligj. Shqipëria nuk ka mekanizëm ligjor shtërngues që të detyrojë Këshillin e Ministrave të miratojë aktet në afat, kështu që çdo reformë apo ligj i rëndësishëm është i destinuar të mbetet në mëshirën e fatit dhe dëshirën e atyre që na drejtojnë.

Por edhe vetë Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk mbetet mbrapa sa i takon "paaftësisë". Janë rreth 20 akte të tjera nënligjore (udhëzime të Ministrit) që duhet të ishin miratuar deri në fund të muajit

¹ Ligji Nr.80/2015

http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/arsimilarte/li gjet/Ligj_80_2015_22_07_2015.pdf

Sipas nenit 141 të ligjit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor brenda nëntë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji duhet të kishin dalë të gjitha aktet nënligjore që e bëjnë funksional zbatimin e tij dhe krijimin e instituteve dhe institucioneve që parashikohen.

prill, por siç dallohet edhe nga faqja e internetit muajt e fundit ka qenë e ngarkuar me festivale dhe ceremoni të ndryshme. Madje MAS ka zhvilluar edhe seminare për orientime drejt karrierës duke harruar që orientimi më i mirë është zbatimi i ligjit, detyrë të cilën e ka harruar. Nga neglizhenca dhe paaftësia e këtij institucioni ne sot nuk kemi udhëzime për dokumentacionin dhe procedurat e hapjes së programeve të reja të studimit, ngarkesat mësimore, format e diplomës, forma e aplikimit për grantet dhe politikat e zhvillimit të IAL-ve. Ky lloj ngërçi ligjor ka krijuar konfuzion tek pedagogët e studentët, ka krijuar pakënaqësi tek kërkuesit shkencorë tek drejtuesit e universiteteve publike dhe private dhe nëse do të vazhdojë deri në fillimin e vitit të ri akademik do të kemi një reformë të dështuar jo nga mungesa e vizionit por nga paaftësia institucionale.

2- Zgjidhje me shkop magjik, ligj me tender

Pasi kaloi rreth një vit nga hyrja në fuqi e ligjit dhe as Këshilli i Ministrave dhe as MAS nuk ja dolën të miratojnë qoftë edhe një akt të vetëm, sytë u drejtuan nga Agjencia e Prokurimit Publik si ilaç i paaftësisë. Ministria e Arsimit dhe Sportit, pavarësisht se në faqen e saj zyrtare nuk ka asnjë shenjë, ka shpallur tender publik me objekt kontrate "Konsulencë në hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të arsimit të lartë", në vlerën e 2.5 milion lekëve pa TVSH.² Nëpërmjet një

² Buletini APP Nr. 19 datë 16 Maj 2016

file:///C:/Users/user/Downloads/Buletini_Nr_19_%20date_16.05.16_perfundimtar.pdf

tenderi me afat një mujor zyrtarët e Ministrisë i kërkojnë ekspertëve përgatitjen e rreth pesëdhjetë akteve nënligjore për të cilat së pari duhet të kërkojnë ndjesë publike që nuk i realizuan dot as për një vit dhe as me paratë që paguhen nga taksapaguesit për të bërë detyrën e tyre. Qytetarët shqiptarë për shkak të paaftësisë së institucioneve, përveç kostos që sjell moszbatimi i ligjit në kohë do të duhet të paguajnë edhe koston ekonomike të ardhur nga kontraktimi i ekspertëve të cilët dot ë bëjnë punën e Ministrisë e cila këtë muaj kishte shumë ceremoni dhe nuk pati kohë të angazhonte departamentin e saj juridik.

MINISTRIA E BUJQËSISE, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE

Marcela TRINGAJ, LLM

1. Problemet me pronat ende pengesë në funksion të bujqësisë

Ngërçi ligjor që pasqyrohet në mosregjistrimin e plotë të pronave këto njëzetë e kusur vite pengon në mënyrë serioze investimet afatgjata edhe në bujqësi. Ky proces bazohet më së shumti në ligjin 7501 "Për Tokën" i cili jo vetëm ka qenë i zvarritës në zgjidhjen e çështjes por shpesh ka gjeneruar konflikte. Pretendentë të rinj dhe të vjetër iu drejtohen një sistemi gjyqësor të korrumpuar ku shpesh rregullat përcaktohen nga oferta më e lartë. Tabloja e konflikteve për tokën është një problem i njohur që shpesh dekurajon investimet e brendshme dhe të huaja për zhvillimin e potencialit ekonomik në turizëm dhe bujqësi.

Vendi tashmë ndodhet në një fazë vendimtare dhe kritike lidhur me procesin e reformës në drejtësi. Rrjedhimisht ky proces do të ndikoj edhe në zgjidhjen përfundimtare të çështjes së pronës mbi tokën e cila pritet të çlirojë investimet dhe kthimin e sektorëve të ekonomisë që lidhet ngushtë me përdorimin e tokës (veçanërisht në sektorin bujqësor) në një mjedis tërheqës për zhvillim të qëndrueshëm rural. Marrja e titullit të pronësisë mbi tokën është e një rëndësie jetike duke sjellë në kornizat ligjore të gjithë veprimtaritë që lind nga e drejta mbi pronën. Fermerët mund të përfitojnë grante nga projekte të ndryshme financiare shtetërore ose jo, mund të përfitojnë kredi lehtësuese për investime në sektorin

bujqësor, mund të përfitojnë të ardhura dhe nga tjetërsimi i saj nëpërmjet shitjes apo qerasë.

Një nga premtimet e qeverisë ishte përfundimi i procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore tek subjektet të përfitimit të tokës bujqësore në pronësi, të cilët e përdorin atë faktikisht. Por në fakt, qeveria ka vendosur ndryshoj këtë afat i cili ishte përcaktuar fundi i muajit qershor të këtij viti. Propozimi i një projekligji me procedurë të përshpejtuar kërkon të shtyjë këtë afat me 18 muaj, përkatësisht deri më 30 dhjetor 2017, sipas qeverisë, kjo për shkak të situatës së rëndë që ka gjetur në hipoteka pas ardhjes në pushtet. Nëse këto propozime do të bëhen çdo herë, në cakun kohor të përfundimit të afateve për përmbushjen e këtij procesi kaq të rëndësishëm dhe nëse instancat përgjegjëse nuk do të kenë vullnetin e mirë për ti dhënë zgjidhje çështjes, atëherë zor se mund të kemi një proces të suksesshëm dhe përfundimtar.

Në fakt, lajmet buçitën për shpërndarjen e 150 certifikatave të para të pronësisë në Novoselë nga 18.500 aplikimeve të mbyllura në dhjetor të vitit 2015. Një pjesë e mirë e administratës së bashkive dhe komunave, aktorë kryesorë në këtë proces, të krijuar rishtazi nga pas zgjedhjeve të fundit vendore, e kanë të vështirë të zhvillojnë një proces normal të shqyrtimit të aplikimeve për shkak të mosnjohjes të procesit dhe mungesa e përvojës. Sigurisht, problemi i mprehtë i pronave nuk pritet të zgjidhet dhe në afatin e ri të propozuar nga qeveria megjithatë e rëndësishme është të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për zgjidhjen e çështjes në rrugë administrative sepse kostot e proceseve gjyqësore do të pengoj ndjeshëm procesin dhe do të prodhojë kosto marramendëse financiare për buxhetin e shtetit dhe do të minojë në

mënyrë të ndjeshme këtë proces kaq delikat.

2.Punë të rëndësishme që mbeten përgjysmë

Nëse zgjedhim të jetojmë shëndetshëm duhet ti shpallim një sfidë të madhe vetes në një vend ky siguria ushqimore është një dështim. Rëndon autoritetet përgjegjëse kërkojnë ta gjejnë fajtorin tek prodhuesit e vegjël dhe ata familjarë. Këta të fundit, shpesh të gjendur mes atyre pak mundësive për mbijetese, në zota të thella malore e rurale, ku kanë lidhur jetën për shkak të të vetmit mundësi për të gjeneruar të ardhura, janë kthyer në "preja" e radhës së Drejtorisë së Bujqësisë Elbasan.

Këtë radhë kjo drejtori do të mjaftohet vetëm me paralajmërime dhe me pas në rast përsëritjeje, do të vijojë me sanksione kundrejt ¹ atyre subjekteve apo individëve që tregojnë gjënë e gjallë pa certifikatën e kontrollit veterinar. Të njëjtin paralajmërim morën edhe subjektet e farmacive bujqësore dhe fermave të zonës. Por këto kontroll-aksione rrufë të ndërmarra nga organet kompetente nuk mundet assesi të kthehen në gardianë të shëndetit të konsumatorëve vetëm me një aksion të vetëm pak ditor. Mungesa e informacionit të vazhdueshëm, mbështetjes profesionale dhe këshillimit të atyre subjekteve, jeta e të cilëve lidhet ngushtë me tokën dhe fermat që disponojnë, është pothuajse zero nga institucionet që ligji nuk iu ka dhënë vetëm tagrat e ndëshkimit. Por duket se do të jetë një rrugë e aspak e lehtë për të gjithë aktorët e përfshirë në këtë çështje.

¹ Elbasan, nis aksioni në tregun e gjësë së gjallë <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=433037>

Një tjetër shqetësim mbesin dhe farmacitë bujqësore. Dy vite me parë Ministri i Bujqësisë Panarit theksoj se shitja e pesticideve nga farmacitë bujqësore duhej bërë bazuar në një recetë të përpiluar nga një specialist agronom². Por edhe sot e kësaj dite, farmacitë bujqësore mund të ofrojnë produktet e tyre tek kushdo dhe pa kurrfarë kriteri. Ndërkohë, vetë etiketat e këtyre produkteve ofrojnë shumë pak informacione mbi mënyrën e përdorimit dhe për dozën që duhet përdorur. Shpesh fermerët bazohen tek përvojat e shkuara në përdorimin e "barnave" për bimët ose tek konsultimet me farmacistët. Neglizhenca në teknologjinë e kultivimit për sa i përket përdorimit të pesticideve, pa ditur mirë kufirin e lejuar, përbën një rrezik madhor për jetën e shëndetin e njerëzve.

Drejtorja e Mbrojtjes së Bimëve e cila është përgjegjëse për dhënien e informacionit për kulturat Bujqësore, nuk ekziston më për shkak të mungesës së specialistëve përkatës. Shpesh këto pesticide nuk janë dëmtues vetëm për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve por ato në mënyrë indirekte dëmtojnë ujin, ajrin dhe tokën. Kërkohej më tepër vëmendje në këtë aspekt nga Ministria e Bujqësisë por ende nuk ka qasje serioze për problemin në fjalë. Jemi mësuar që punët në këtë vend të behën me fushata dhe aksione. Nëse ngrihet një problem shqetësues, për fatin tonë të keq, tre ditë zgjat shqetësimi dhe angazhimi i enteve përgjegjëse. Më pas çdo gjë harrohet dhe punë të rëndësishme që trumbetojnë gjatë identifikimit të tyre mbeten përgjysmë. Dhe kjo histori përsëritet.

² Farmacitë bujqësore, pesticide pa recetë për fermerët <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=433299>

MINISTRIA E DREJTËSISË

Endrit KAPAJ, LLM

1-Drejtësi e vonuar, drejtësi e mohuar.

Ministri i Drejtësisë, z. Ylli Manjani ka marrë pjesë në prezantimin e nismës "Për një drejtësi pa vonesa". Gjatë fjalës së tij, Ministri Manjani theksoi se gjykatat duhet të veprojnë me shpejtësi, duke nënkuptuar se ku ka vonesa, ka edhe korrupsion, ndërkohë që u ndal edhe në nocionin e standardit të gjykimit të pandërprerë, duke e cilësuar atë si mjaft të rëndësishëm dhe një kusht i cili duhet respektuar medoemos.¹

Duhet te theksojmë se, e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm është një nga të drejtat thelbësore procedurale të njeriut dhe një gur themeli i një shoqërie të bazuar në shtetin e të drejtës. Qëllimi i kësaj garancie është mbrojtja e "të gjitha palëve të përfshira në procedurat gjyqësore...ndaj vonesave të tepruara procedurale"². E drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm parashikohet në nenin 6, paragrafi 1 të KEDNj-së dhe zbatohet si për gjykimet civile, ashtu edhe ato penale.

Në pasqyrim të standardeve ndërkombëtare, neni 42 (2) i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë thotë se kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë

¹ Pwr njw drejtswi pa vonesa: <http://www.drejtësia.gov.al/al/newsroom/lajme/mini-stri-i-manjani-merr-pjese-ne-prezantimin-e-nismes-per-nje-drejtësi-pa-vonesa&page=1>

² Udhëzimet SATURN për menaxhimin e kohës së gjykimit, pjesa I.E, pika 1

dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në mënyrë të ngjashme, neni 28 i KPrC-së thotë se gjykata duhet ta gjykojë çështjen brenda një "afati të arsyeshëm".³

Këshilli i Lartë i Drejtësisë i ka orientuar gjykatat lidhur me afatet kohore procedurale për disa lloj çështjesh.⁷² Këto afate kohore përdoren kur vlerësohet puna e gjyqtarëve. Afatet kohore, siç tregohet më poshtë, fillojnë që nga regjistrimi i çështjes në gjykatë. Afatet e gjykimit në shkallën e parë Gjykimet e mosmarrëveshjeve tregtare – maksimumi 6 muaj. Gjykimet e mosmarrëveshjeve familjare – maksimumi 4 muaj. Gjykimet e mosmarrëveshjeve administrative – maksimumi 1 muaj. Gjykimet e mosmarrëveshjeve civile me karakter të përgjithshëm – maksimumi 6 muaj.

Vjetari Statistikor, një botim i Ministrisë së Drejtësisë që përmban statistika zyrtare për gjyqësorin, tregon që në vitin 2009, 26 % e të gjithë gjykimeve civile në Shqipëri ishin pushuar për shkaqe procedurale, ndërsa 73.9 % ishin gjykuar në themel. Duke qenë se pushimi nuk e pengon paditësin të rifillojë çështjen, kjo përbën një harxhim të konsiderueshëm burimesh për gjykatat dhe palët.⁴

Sa më sipër, problemi i afati dhe kohëzgjatja e gjykimit ne tërësi mbetet një problem për tu adresuar edhe në kuadër të paketës ligjore të Reformës në Drejtësi.

³ Neni 28 i KPrC-së parashikon që gjykatat duhet të shprehen për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.

⁴ Ministria e Drejtësisë, Vjetari Statistikor 2009 (Tiranë, Ministria e Drejtësisë, 2010) faqe 160.

2-Ç'duhet bërë për të reduktuar kriminalitetin në shoqëri?

Ministri i Drejtësisë, z. Ylli Manjani, në emër të Këshillit të Ministrave i ka përcjellë Prokurorit të Përgjithshëm, z. Adriatik Llalla rekomandimet që duhet të mbahen parasysh për vitin në vazhdim, në luftën kundër kriminalitetit. Kryerja e hetimeve të shpejta dhe efikase, rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional, forcimi i rolit të Këshillit të Prokurorisë, etj., kanë qenë disa nga çështjet e sjella në vëmendje nga ana e Ministrit Manjani.⁵

Drejtësia penale është një ndër shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës. Në ditët e sotme ajo përballlet me format e reja të sofistikuar të kriminalitetit që kërkojnë rritjen e efektivitetit të legjislacionit e të veprimtarisë së institucioneve dhe strukturave e agjencive të specializuara në luftimin e kriminalitetit. Për këtë arsye nevojitet përfundimi i reformave në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe ligjeve të tjera në mënyrë të studiuar dhe duke përmirësuar procesin e ligjbërjes. Duke njohur dhe zbatuar në praktikë sistemin e normave penale juridike e procedurale penale, si dhe duke vënë në lëvizje funksionimin normal të vetë sistemit të drejtësisë penale për zbatimin e normave penale juridike, do të mund të rritet në shkallë më të lartë efektiviteti i drejtësisë penale për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në luftimin e kriminalitetit dhe parandalimin e tij. Analizat e bëra në këtë temë synojnë të japin ndihmesë për të ngritur në nivele më të larta të gjitha standardet, duke filluar

nga integriteti moral, profesionalizmi i punonjësve të të gjithë sistemit të drejtësisë penale, reformat e nevojshme të trajtimit të tyre financiar e të karrierës si dhe forcimin e kontrollit vertikal e horizontal mbi organet e drejtësisë. Objektivi kryesor është që në Shqipëri të arrihet të jepet drejtësi dhe drejtësia të fitojë besimin e publikut.

⁵ Politika për reduktimin e kriminalitetit: <http://www.drejtësia.gov.al/al/newsroom/lajme/lufta-kunder-kriminalitetit-ministri-manjani-rekomandime-prokurorit-te-pergjithshem&page=1>

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRISË

Ergisa BEJKOLLARI, BA

1-“Piramida ARMO” shembet dhe zë poshtë 4000 familje!

Kur thamë që falimenti i ARMO-s mund të parashikohej, paskemi pasur të drejtë! “Prapaskenat e kolapsit të gjigandit të hidrokarbureve ARMO”, ky është titulli që përshkruan ndoshta vjedhjen më të madhe në historinë e Shqipërisë!¹ Një histori e tërë që tregon sesi biznesmeni i njohur Rezart Taçi bëri për vete miliona dollar në harkun kohor të viteve 2008-2013, duke shkatërruar kështu ARMO-n dhe jetën e 4000 të punësuarve në të. Ndonëse pjesa më e madhe e mashtrimit ka ndodhur nën qeverisjen e mëparshme, duke shmangur taksat dhe duke tërhequr me vete dhe bankat e nivelit të dytë me anë të kredive të këqija, auditi që zbuloi “gangrenën” e kompanisë u realizua në gusht të vitit 2013. Dy muaj pas ardhjes në pushtet të qeverisë aktuale, njëra nga kompanitë më të mëdha të auditit në botë, identifikoi kolapsin në të cilën ishte futur ARMO.

“Sfida jonë është të gjejmë një operator privat që do menaxhojë në mënyrë eficiente kompaninë” tha z. Gjijnuri para se ARMO të ishte pranë falimentimit. Pra sipas ministrit Gjijnuri njëra nga synimet e kësaj qeverie do ishte padyshim menaxhimi i mirë i ARMO-s. Kjo gjë nuk u realizua duke qenë se më 20 maj qindra punëtorë protestuan para kryeministrit. 1200 naftëtarë nuk paguhen prej 10

¹ Artikull: “Prapaskenat e kolapsit të gjigandit të hidrokarbureve ARMO”
<http://www.reporter.al/prapaskenat-e-kolapsit-te-gjigandit-te-hidrokarbureve-armo/>

muajsh! Ne thamë që ishte diçka që parashikohej për disa arsye:

1. Dihet tendenca e kompanive shqiptare për të shkurtuar vende pune në rast falimenti.
2. Dihej rënia e çmimeve të naftës në tregun botëror. Ne këtë e konstatuam dhe e paralajmëruam dhe në raportin e APPA-s.²
3. Të dhëna tregojnë që ARMO, e cila ka në pronësi dy rafineri në Fier dhe Ballsh, deri në vitin 2014 kishte më shumë se 500 milion dollarë detyrime ndaj autoriteteve fiskale, bankave, furnitorëve dhe palëve të tjera.

A nuk janë të mjaftueshme këto 3 arsye që të merreshin masa emergjente për mbrojtjen e punonjësve? Sepse ndërkohë që Rezart Taçi u arrestua në Zvicër dhe 1.3 milionë dollarë iu sekuestruan,³ ne vazhdojmë të këmbëngulim në një zgjidhje të shpejtë për situatën e tmerrshme ekonomike ku gjenden familjet e Ballshit dhe Fierit, të cilët të paktën sipas programit të paraqitur në vitin 2013, individët e papunë do të ri integroheshin në tregun e punës. “Programin e deritanishëm të sigurimit të papunësisë ne do ta shndërrojmë në Programin e Sigurimit të Punësimit dhe do të përfshijmë në këtë program çdo individ që humbet punën” shkruhet në programin e premtuar të Partisë Socialiste.⁴

² Raport i APPA-s për janar-shkurt 2016.
<http://appa.al/raport-janar-shkurt-2016-ministria-e-industrise-dhe-energjitikes/>

³ Artikull në lidhje me arrestimin dhe sekuestrimin e pasurisë së biznesmenit Rezart Tacci në Zvicër.
<http://exit.al/2016/05/09/zvicer-arrestohet-rezart-taci/>

⁴ Programi politik i Partisë Socialiste i hartuar në kuadër të zgjedhjeve të vitit 2013.
<http://www.edirama.al/files/ProgramiPS.pdf>

2- Si të kalosh nga kompani e bllokuar në kompani fituese koncesioni brenda një viti?!!

Më 11 maj 2016 në fletoren zyrtare gjendet i botuar vendimi për miratimin e licencës së koncesionit kundrejt shoqërisë aksionare AM-OIL.⁵ Bëhet fjalë për një koncesion 30-vjeçar, i cili i jep të drejtën kompanisë të kryejë veprimtarinë e përpunimit të naftës bruto dhe prodhimin e nënprodukteve të saj.

Me një kërkim të thjeshtë në dokumentet online të QKR-së⁶, zbulohet se bëhet fjalë për një kompani e cila e ka nisur aktivitetin e saj në vitin 2009 dhe që merret me projektimin, ndërtimin dhe përdorimin e impianteve teknologjike (rafinerive), tubacioneve dhe depozitave për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Ajo ka një kapital fillestar prej 3,500,000 lekësh me vendndodhje tek ish-uzina e Plastmasit në Lushnje. Koncesioni 30-vjeçar në fakt nuk i është dhënë një kompanie të panjohur (domosdoshmërisht), pasi AM-OIL në vitin 2009 rezulton në listën e subjekteve të bllokuara për mungesë dokumentacioni. Nga tabela e akt-blokimeve⁷ të bëra gjatë inspektimeve të periudhës prill 2015 nga Inspektorati Qendror Teknik, shohim që

⁵Botim në fletoren zyrtare i datës 11 maj 2016 për vendimin e dhënies së koncesionit ndaj kompanisë AM-OIL.

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/82-2016.pdf

⁶ Informacioni që disponohet në QKR oër subjektin AM-OIL.

http://www.qkr.gov.al/nrc/Kerko_Per_Subjekt.aspx

⁷Tabela e bllokimeve të kryera nga IQT në prill të vitit 2015.

<http://www.ishti.gov.al/ep-content/uploads/2015/05/BLLOKIMET-E-KRYERA-GJATE-MUAJIT-PRILL-20151.pdf>

për shoqërinë aksionare AM-OIL është dhënë një urdhër bllokimi për mungesë dokumentacioni.

Pra një vit para se kjo shoqëri të përfitonte një koncesion 30-vjeçar, asaj i bllokohet aktiviteti. Sigurisht që kur bëhet fjalë për një koncesion të kësaj vlere është e pamundur të mos jetë shqyrtuar historiku i mëparshëm i kompanisë, dhe nëse kjo gjë është bërë lind dyshimi i arsyeshëm sesa i ligjshëm mund të jetë ky vendim që është marrë!

MINISTRIA E FINANCAVE

Elena PICI, MSc

1-Ballafaqimi me të vërtetat

Gjatë muajit Maj, fjalimet që u mbajtën gjatë 'Dialogut politik të nivelit të lartë mbi klimën e biznesit dhe tërheqjes së investimeve', sollën në vëmendje të vërteta mbi ecurinë ekonomike të Shqipërisë. Përfaqësuesja e Bankës Botërore për Shqipërinë, znj. Tahseen Sayed mbajti një fjalim me kontekst historik për rritjen ekonomike të vendit, ku theksoi dy pika të rëndësishme. E para, që Shqipëria ka pasur rritje shumë të fuqishme në periudhën nga viti 1992 deri në vitin 2008, kohë gjatë së cilës mirëqenia u rrit, varfëria u ul dhe hendeku mes nivelit ekonomik të shqiptarëve dhe hendekut ekonomik të evropianëve u pakësua, sido që, ky ngushtim hendeku nisi nga një bazë shumë e ulët dhe mbetet sot në nivele shumë të larta. E dyta, që nga viti 2008 deri më sot, varfëria është rritur në vend që të ulet dhe ngushtimi i hendekut mes nivelit ekonomik të Shqipërisë dhe të BE-së ka ndaluar së pakësuar. Mbi të gjitha ajo shtoi se institucioni që përfaqëson parashikon se: *'Shqipërisë i duhet një rritje mesatare mbi 4,5 përqind në vit me qëllim që të arrijë standardet e jetesës të BE brenda disa dekadave'*.¹

Në fakt pritshmëritë në fillim vitet 2000, llogarisnin një skenar të mundshëm të rritjes së ekonomisë shqiptare me 6 për qind në vit, ndërsa ekonomia e Bashkimit Europian do të rritej me 2 për qind në vit dhe atëherë ekonomia shqiptare do të barazohej me mesataren e Bashkimit Europian në vitin 2046². Realiteti është që rritja ekonomike prej 4,5 për qind, për të

¹ Lexo fjalimin e plotë: Eorl Bank. Maj 2016. <http://ëëë.ëorlbank.org/sq/neës/speech/2016/05/24/speech-by-albania-country-manager-on-business-climate-and-investment-attractiveness>

² Erebara, Gj. Maj 2016. <http://ëëë.reporter.al/endrra-e-barazimit-me-europen-rrezikon-te-mbetet-thjesht-enderr/>

cilën flet znj. Sayed, nuk është parë që nga viti 2008. As perspektiva nuk është kaq e afërt, pasi në vitin 2014, Fondi Monetar Ndërkombëtar parashikonte që Shqipëria do të kthehej tek rritja 4.5 për qind në vitin 2018, por parashikimet aktuale e shtyjnë atë në 2021³.

Sigurisht që realiteti i sotëm ekonomik është pasqyrim i vendimeve të marra gjatë 2 dekadave të fundit dhe jo vetëm dy viteve të fundit, si dhe reflekton faktorë të jashtëm të krizës financiare të 2008. Sistemi i administrimit të buxhetit të shtetit dhe të borxhit publik kanë qenë faktorë kyç për mos realizimet. Në vend që Shqipëria të shlyente një pjesë të borxhit publik mes viteve 2002 dhe 2008, kur ekonomia që në rritje, borxhe të reja u morën për të ndërtuar rrugë ku nuk ka makina për të qarkulluar, për të rritur paga e pensione me ritëm më të shpejtë se sa rritja ekonomike e për të instaluar sistemin e votave në këmbim të vendeve të punës. Borxhi publik është kthyer në një formë skeme piramidale, interesat e të cilit janë efektivisht më të shtrenjta se sa rritja ekonomike e vendit. Megjithatë, ajo që mendojmë se i takon qeverisë aktuale (si fillim) është ballafaqimi me të vërtetat.

Ministri Ahmetaj në po të njëjtin event u shpreh se: *'Në qoftë se Bashkimi Europian sot rritet me 1 për qind dhe ne rritemi me 6 për qind, vetëm në vitin 2038 të ardhurat për frymë të qytetarëve shqiptarëve do të barazohen me të ardhurat për frymë të qytetarëve të Bashkimit Europian'*. Teorikisht një grafik i thjeshtë makroekonomie do të na nxirrte këtë rezultat, por sa realisht e mundshme është kjo? BE nuk është shembulli i rritjes ekonomike, por gjithsesi vazhdon ta ketë më të lartë rritjen se 1% (1.4% dhe 1.9% në 2014 dhe 2015 respektivisht⁴). Nga ana tjetër, siç parashtruum dhe më sipër, skenari i zhvillimit të Shqipërisë është larg

³ Exit.al. Maj 2016. <http://exit.al/2016/05/28/12604/>

⁴ Eurostat <http://ec.europa.eu/eurostat/tgm/table.do?tab=table&init=1&language=en&pcode=tec00115&plugin=1>

4.5%-shit, kështu që sigurisht edhe më larg 6%-shit (të paktën për një dekadë). Për më tepër, gjykojmë se përqendrimi i shumtë tek shifrat si të ardhura për frymë nuk pasqyrojnë realisht zhvillimin e standardit të jetesës në një ekonomi gjithëpërfshirëse. Kjo do të thotë se mesatarisht të ardhurat për frymë mund të rriten, por kjo rritje mund të vijë si pasojë e shtimit të të ardhurave vetëm tek top 10% më i pasur i popullatës. Kur kjo rritje pjesëtohet për numrin e popullsisë, eklipson në fakt një situatë të rritjes së pabarazive në të ardhura. Prandaj, që një ekonomi të jetë njerëzore (human ekonomi, ekonomi for the people), e ardhura për frymë si indikator duhet të shoqërohet me të dhënat për uljen e varfërisë, uljen e papunësisë etj.

Duket se Ministri Ahmetaj nuk ballafaqohet as më të vërtetën e deflacionit⁵. Në një takim me studentët e fakultetit të ekonomisë, z. Ministër u shpreh: *'Përtej debatit politik që dëgjoni "ra ekonomia", "deflacioni", se e marrin deflacionin dhe duan ta kthejnë në një instrument politik pa i hyrë fare cilësisë dhe statistikës dhe bazës përtej shifrës, këto janë shifra që tregojnë se ekonomia shqiptare ka dalë nga kriza. Legjenda e konsumit ju jep një shifër shumë interesante, me tre tremujor radhazi me rritje. Tremujori i tretë i vitit 2015, tremujori i katërt i vitit 2015 dhe tremujori i pari i këtij viti ka rritje të konsoliduar konsumi'*. Ne nuk dimë të dhëna publike për konsumin e tremujorit të parë të 2016-tës, por në lidhje më 2015, vetë INSTAT konfirmon uljen me 0.2% të konsumit. Për më tepër kjo ulje vjen për herë të parë që nga 2001 dhe për vitin 2015 ka pasur ulje vetëm në Shqipëri dhe Serbi, krahasuar me vendet e tjera të rajonit⁶.

Edhe në konferencën "Reforma në Ekonomi dhe Klima e Biznesit", organizuar nga

⁵ Shiko APPA.al. Raporti i Ministrisë së Financave. Muaj Prill.

⁶ Ekspres.al. Maj 2016.

http://ëëë.ekspres.al/index.php?option=com_content&view=article&id=36870:2016-05-19-18-03-28&catid=112:lajme-kryes

Ministria e Financave gjatë këtij muaji, Kryeministri shmang të vërtetat e ankesave të biznesit⁷. Në fakt nuk janë fokus i këtij raporti qëndrimet e Kryeministrit⁸, por ne gjykojmë se një ndërhyrje e Ministrit Ahmetaj në atë rast do të ishte me vend për të treguar mbështetjen ndaj bizneseve. Vetëm në atë skenar retorika e vazhdueshme e institucioneve të financave në lidhje me partneritetit me biznesin do të kishte pasqyrim konkret.

Ndoshta nga pikëpamja e politikë-bërjes, pretendimi ynë për ballafaqim me të vërtetat gjatë ligjërimit publik është i tepër. Ndoshta secili nga ne Ministër do t'i interpretonte faktet në atë këndvështrim që të pasqyronin rritje ekonomike. Megjithatë, ballafaqimi me të vërtetat është edhe më i rëndësishëm gjatë marrjes së vendimeve dhe reformave. Edhe nëse nuk duan të pranojnë deflacionin (ose kanë pikëpamje të ndryshme rreth tij), të paktën është e rëndësishme veprimi kundra tij me instrumentet e duhur ekonomikë. Në kushtet e inflacionit të ulët këshillohen politika stimuluese monetare (ulje e normës së interesit) dhe fiskale (rritje të shpenzimeve qeveritare). Ulja e normës së interesit ka arritur tashmë minimumin historik prej 1.25 për qind. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë Gent Sejko deklaroi se bankat duhet të kenë më shumë guxim në dhënien e kredive, ndryshe rritja e pritshme prej 3.4 për qind nuk mund të arrihet⁹. Por, të jesh i guximshëm, në termat bankar, do të thotë edhe të pranosh të financosh klientë me plane biznesi me të ardhura të paqarta, ose pak të mundshme, ose akoma më keq pa asnjë garanci financiare ose pasuri të patundshme të kërkuara nga ligjet në fuqi, gjëra të cilat e

⁷ Sot.com. Maj 2016.

<http://ëëë.sot.com.al/politike/ramës-ja-plas-në-sy-të-vërtetën-biznesmeni-i-huaj-kryeministri-i-ndërpret-fjalën-dhe-e>

⁸ Për më tepër lexo raportet APPA për Kryeministrinë

⁹ Exit.al. Maj 2016.

<http://exit.al/2016/05/07/thirrja-e-deshperuar-e-guvernatorit-sejko/>

vejnë bankën përpara një risku të madh të mos shlyerjes së kredive. Në një situatë ekonomike jo të qëndrueshme dhe më luftën kundër informalitetit (për të cilën jo se jemi kundra në parim), ulja e normës së interesit nuk ka sjellë rritje të huamarrjes as tek individët as tek bizneset.

Prandaj, gjykojmë se ballafaqimi me të vërtetat nënkupton (si të vetmen alternativë të mbetur) realizim të shpenzimeve qeveritare (kryesisht kapitale), të cilat edhe këtë 4 muaj të parë të 2016 ishin realizuar në masën 74%¹⁰. Ballafaqimi me të vërtetat duhet te sjellë rritje pagash në administratë dhe ky është një instrument të cilin ne e kemi vënë në dukje dhe në raportet e mëparshme. Këtë muaj edhe ekspertë të ekonomisë kanë ndarë të njëjtin qëndrim. Z. Preçi nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike gjatë një interviste u shpreh: 'Në këto kushte një rritje e pagave do të kishte efekte të menjëhershme në konsum. Pasi nëse qeveria hedh 5 apo dhjetë milionë euro paga, në tre muaj efekti i tyre do të shumëfishohej duke mbajtur në këmbë edhe bizneset e vogla si dhe duke përmirësuar perceptimin e përgjithshëm'.¹¹

Ballafaqimi me të vërtetat nënkupton se zhvillimi i qëndrueshëm i vendit nuk vjen nga

investime infrastrukturore që thjeshtë janë të dukshme, mundësojnë ca prerje shiritash në kohë të shkurtër dhe po për aq kohë të shkurtër punësojnë fuqi punëtore. Zhvillimi ekonomik kërkon reforma strukturore që janë të bazuara në ekonominë e aftësive (ekonomi of skills) dhe si e tillë kërkon investime në kapitalin human. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik nuk vjen nga rritje e numrit të partneriteteve publiko-private (PPP), të cilat edhe vetë FMN-ja në raportin e saj

¹⁰ Ministria e Financave. Maj 2016.

<http://ëëë.financa.gov.al/al/neësroom/lajme/pu-blikohen-treguesit-fiskale-paraprake-te-4-mujorit-2016&page=1>

¹¹ Top Channel. Maj 2016. <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=326247&fundit>

publik këtë muaj këshilloi: 'Duhet më shumë transparencë për procedurat që përdor qeveria për koncesionet apo PPP-të si dhe për çdo koncesion apo PPP qeveria duhet të hartojë dhe publikojë një analizë kosto-përfitimi dhe të ndjekë me rigorozitet praktikat ndërkombëtare'.

Në fakt në këtë kuadër, i vetmi ballafaqim me të vërtetat i cili është për t'u përgëzuar është projekt-ligji organik për buxhetin. Një ndër pikat më të rëndësishme të projekt-ligjit është: 'Asnjë qeveri nuk ka të drejtë, pra hiqet e drejta me këtë ligj, që të rrisë borxhin, përkundrazi, i jep detyrimin afatgjatë që vetëm të ulë borxhin deri në atë nivel, ku të gjithë ne, majtas dhe djathtas, i referohemi si niveli i sigurisë së borxhit publik për Shqipërinë që është 45% e PPB'¹². Pika tjetër po kaq e rëndësishme (për të cilën nuk dimë nëse ka qenë vullneti i plotë i qeverisë apo dhe një farë imponimi nga FMN, por që gjithsesi po kënaqemi me rezultatin sesa shkakun) është futja e konceptit 'detyrime thujtse fiskale' dhe këtu është fjala pikërisht për kontratat koncesionare. Ky koncept parashikon që kostot buxhetore p.sh. dializës, Checkup falas e sterilizimit, t'i kontabilizojë si detyrime buxhetore, me shpresë se një masë e tillë do të ndalojë qeverinë të marrë borxhe të reja, të cilat, teknikisht nuk quhen borxhe por koncesione. Për fat të keq, ndryshimi i një ligji nuk e zëvendëson nevojën për të pasur vullnet politik dhe sistem kontrolli mbi politikën për të garantuar që shpenzimet publike dhe buxheti i shtetit të shërbejë për të ndihmuar rritjen e ekonomisë dhe jo për t'u bërë barrë dhe pengesë për rritjen ekonomike¹³.

Të vërtetat duhen ballafaquar. E në mos nuk ballafaqohen në të thënat publike, ato

¹² ¹³ Fjala e Ministrit Ahmetaj në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë. Maj 2016.

<http://ëëë.financa.gov.al/al/neësroom/lajme/ligj-i-organik-i-buxhetit-ministri-ahmetaj-ne-komisionin-parlamentar-te-ekonomise&page=1>

¹³ Erebara, Gj. Maj 2016.

<http://ëëë.reporter.al/endrra-e-barazimit-me-europen-rrezikon-te-mbetet-thjesht-enderr/>

duhen të ballafaqohen në të bërat – në planifikim dhe zbatimin e reformave dhe vendimet ekonomike-financiare me realizëm dhe profesionalizëm. Ky është hapi i parë i një zhvillimi të qëndrueshëm.

MINISTRIA E INTEGRIMIT

Rezarta CAUSHAJ, BA

1- Dita e Europës: Shqipëria Vs. BE

Po e fillojmë raportimin e këtij muaji me një krahasim të aktiviteteve të mbajtura me rastin e 9 Majit, i cili është festuar si në Tiranë, edhe në institucionet e BE. E njohur gjerësisht si Dita e Europës, kjo ditë rikujton Deklarata Schuman që shënoi fillimin e projektit politik të Bashkimit European që njohim sot. Në vendin tonë është zhvilluar nga Ministria e Integrimit një aktivitet i titulluar sporadikisht "EU Tranzit", ku janë ftuar zyrtar shqiptar, european e ambasador dhe i konceptuar si një aeroport, simbolika të bën të kuptosh se vendi jonë pret të marr avionin për në BE.

E gjithë Festa Tematike në fakt rezultoi thjeshtë një nga inskenimet e zakonshme, në të cilën u përfitua edhe një herë për të organizuar një panair për reklamim biznesi dhe për mbajtjen e fjalimeve të zakonshme. Duke iu referuar fjalimit të Znj. Gjoshë, qytetarët shqiptar mund të mendojnë se mjafton miratimi i reformës në drejtësi nga palët për të hyrë në BE, ndërkohë që e vetmja shpresë që kemi me zbatimin e jo thjeshtë miratimin e reformës, është hapja zyrtare e negociatave për hyrjen në BE. Duhet të rikujtojmë ndoshta se edhe në rastin më optimist, fqinji jonë Serbia, e cila mori aprovimin në vitin 2014 për hapjen e negociatave, ende nuk ka filluar bisedimet për kapitujt e Aquis pas dy viteve. Vlerësojmë se organizimi i eventeve të tilla ka për qëllim vetëm t'i shërbejë një axhendë të kufizuar politike, ku tentohet të luhet me shpresat për hyrjen e shpejt në BE e ekzaltimin e zakonshëm të një turme të vogël në qendër të qytetit. Më konkretisht, thirrja e Ministrit ndaj qytetarëve për të ecur shpejt përndryshe do humbasin avionin për në BE nuk ka sens në një vend ku qytetarët nuk janë përgjegjës për mos përparimin në reforma.

Ndërkohë, në BE festimet përqendrohen kryesisht në Bruksel e Strasburg dhe më shumë se festë shërben si një ditë ndërgjegjësimi, sidomos ri kujtesë mbi fillimet e BE dhe arsyet e krijimit të tij për t'i dhënë fund luftërave në Europë. Presidenti Schulz, duke iu referuar idesë së krijimit të BE jo menjëherë, por hap pas hapi nëpërmjet arritjesh konkret, I mëshoi fortë respektimit të të drejtave të njeriut, paqes dhe faktit që ka ardhur koha që të luftohet për BE. Më tepër se rikujtimin e një ditë, BE hap dyert e institucioneve gjatë gjithë muajit dhe aktivitetet janë kryesisht debate mbi problemet më të nxehta të BE, seminare më anë të të cilave zbulohen shqetësimet e një qytetari european, stenda ku ofrohet informacion qytetarëve e deri te festivalet rajonale. Duke qenë se vetë BE gjendet vetë në një moment krize, është e rëndësishme analizimi i këtyre aktiviteteve si një mënyrë për të reflektuar se cila është qasja më e mirë për zgjidhjen e problemeve, ku orientimi ndaj qytetarëve, pyetja e përfshirja e tyre është gjithmonë një fillim i mirë.

2- Gjithëpërfshirja

Është trajtuar në Sesionin Përmbledhës të Konventës për Integrimin European çështja e institucionalizimit të debatit mbi procesin e integrimit, duke tentuar të përfshihen edhe aktor nga biznesi apo shoqëria civile. Kjo nismë është e mirëpritur duke qenë se BE ka përsëritur herë pas here mungesën jo vetëm të pjesëmarrjes së shoqërisë civile, por mungesën në vendimmarrje të saj.

Në këtë aspekt na ka habitur deklarata e Znj. Gjoshë, ku konkretisht ajo shprehet "Ministria e Integrimit i është përmbajtur rolit të saj koordinues për të standardizuar konsultimet më këta aktorë, duke i pasur periodike ku veçanërisht me shoqërinë civile jemi përpjekur të kemi një bashkëpunim konkret dhe të frytshëm", tha Ministrja Gjoshë". Habia vjen për shkak se në asnjë cep të portalit zyrtar të Ministrisë nuk gjenden takime periodike me shoqërinë civile, nuk gjenden shpallje për

takime, nuk gjenden axhenda për diskutime me shoqërinë civile. Në vazhden e kësaj që sapo thamë, në Konventë janë formuar 4 grupe pune me pjesëmarrje nga institucione shtetërore, OJF, sektor privat, media e akademik. Natyrisht asnjë e dhënë nuk publikohet mbi kriteret e zgjedhjes së tyre apo sa ka qenë koha e paralajmëruar për përfshirjen e tyre.

Për të njëjtën problematik është shprehur këtë muaj edhe Këshilli Kombëtar i Integritimit, ku në mbledhjen e radhës është lajmëruar se së shpejti do nisin një sërë aktivitete nëpër rrethe, që kanë për qëllim informimin mbi përfshirjen e grupeve të ndryshme të interesit si dhe mbajtjen e Shkollës Verore për Çështjet e Integritimit për herë të parë me shpresën e krijimit të një akademie rajonale që do të aftësojë një grup negociator me bazë të gjerë, i cili të ofrojë ekspertizë duke u angazhuar në proces.

Vlerësojmë se të dyja këto nisma do të ishin mjaftë pozitive nëse do të realizoheshin mbi baza meritokracie, pa u ndikuar nga përzgjedhjet partiake apo njohjet personale.

3- IPARD në vëmendje

Programi i Instrumentit të Para Aderimit për Zhvillimin Rural, i parashikuar të ndihmojë vendet aspirante për ngritjen e programeve të zhvillimit të bujqësisë në standardet e BE, ka ardhur në vëmendje këtë muaj pas konfirmimit se ky program do të kompensojë dëmet e pësuar nga fermerët gjatë përmytjeve të shkurtit 2015, nga i cili kanë përfituar 3,529 fermerë me negociim të Ministrisë së Integritimit.

Duke marr shkas, jemi përpjekur të gjejmë se si ka qenë ecuria e programit deri më sot, cilat kanë qenë arritjet apo projektet e zbatuara, a kanë qenë ose jo të suksesshme.

Nga çka zbuluam, duke hulumtuar ueb sajtin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillim Rural dhe Bujqësor, është që shumica e këtyre fondeve përdoren vetëm si mjet subvencionimi, ku një ide më të saktë e jep një VKM e datës 10.02.2016, e cila përshkruan të gjitha rastet kur ofrohet subvencioni dhe masa e përfituar. Nuk ka asnjë referencë se çfarë mund të bëhet për të inkurajuar përdorimin e teknologjive moderne në sektorët e bujqësi-blegtorisë, që është një nga qëllimet e programit. Ajo çka nuk sqarohet, por nënkuptohet edhe duke i hedhur një sy seksionit të "Pyetjeve më të shpeshta" është se buxheti i limituar kushtëzon numrin e përfituesve nga njëra anë dhe nga ana tjetër, që nuk ka një dokument strategjik, i cili të evidentojë cilat janë problemet më të mprehta, nevojat më emergjente si dhe një hierarki prioritete që të orientojë programin bazuar edhe në mundësitë financiare që ofron.

Një shembull mjaftë i mirë për t'u marr parasysh në këtë rast do të ishte ai i vendit fqinj, Serbisë, ku Ministria e Agrikulturës dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka bërë zbrëthimin e programit në fjalë për periudhën 2014-2020, duke zbuluar çka çalon e cilat janë fushat me më shumë potencial zhvillimi.

MINISTRIA E KULTURES

Blerina LLALLA, MSc

Muaji Maj në Ministrinë e Kulturës vijon me një sërë aktiviteteve artistike kulturore organizuar nga institucionet e vartësisë apo me mbështetjen e këtij dikasteri. Ajo që po vëmë re kryesisht këtë periudhë mbetet konteksti formal dhe promovues (një gjë e mire në lidhje me promovimin për disa artiste apo individë) por që ngre pikëpyetje mbi aspekte të tjera të aktivitetit të punës së kësaj Ministrie, pasi ajo çka kemi nevojë të shohim nga liderët e këtij institucioni është jo vetëm pjesëmarrja në aktivitete apo evente artistike të shumëpritura por edhe një diskutim e bashkëpunim më i gjerë në hartimin dhe përpilimin e politikave të reja apo raportimeve më konkrete mbi projekte në sektorin e kulturës dhe trashëgimisë kulturore, sidomos në periudhën e lulëzimit të turizmit kulturor.¹ Por këtë herë do të ndalemi në aspekte të tjera të punës së kësaj Ministrie pasi do të donim të dënim më konkretisht deri ku jemi me disa procese të nisura prej kohësh dhe për të cilat nuk kemi një informim në mënyrë konstante.

Dy fjalë për të shumëpriturën reformë ligjore të trashëgimisë kulturore

Prej rreth dy vitesh qëndrojmë në pritje të riformulimit të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore, proces mbi të cilin nuk ka pasur një informim në mënyrë konstante ndaj publikut. Ndërkohë që do të ishte shumë e nevojshme duke iu referuar zhvillimeve të fundit në kontekstin menaxheriale të institucioneve të linjës dhe implementimit

¹ Faqja e MK- sesioni Lajmeve <http://www.kultura.gov.al/al/newsroom/lajme>

të programeve apo praktikave të ruajtjes, mirëmbajtjes e zhvillimit të projekteve në funksion të konservimit, promovimit apo mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të monumenteve të kulturës shqiptare. Publikimi i fundit mbi procesin e punës për reformën ligjore në sektorin e trashëgimisë kulturore daton rreth tetë muaj më parë, kjo publikuar vetëm në faqen zyrtare të MK në rrjetet sociale, gjatë një takimi me përfaqësues të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim.² Në muajt në vijim e deri më sot ende nuk kemi një konkretizim të kësaj nisme.

Nëse do t'i hidhnim një vështrim historikut të përpunimit apo ndryshimeve në ligjin për trashëgiminë kulturore në vendin tonë, edhe pse pas viteve të tranzicionit ka pësuar përmirësime, jemi të ndërgjegjshëm që ka sërish hapësira për tu përshtatur apo ndryshuar dhe në bazë të sugjerimeve të eksperteve vendas apo të huaj. Nevoja për rishikim ekziston edhe pas ndërhyrjeve të kryera në ndikimin e legjislacioneve të vendeve perëndimore me dëshirën e mirë dhe përpjekjen për tu përshtatu me to apo praktika të avancuara bashkëkohore. Kjo nevojë vjen jo vetëm për tu renditur kah aleatëve ndërkombëtare në politikën e fushës por edhe për faktin se sistemi aktual i Trashëgimisë Kulturore në vendin tonë kërkon një riorganizim rrënjësor për të siguruar së pari një administrim dhe menaxhim më të mirë sipas standardeve dhe risive të kohës në funksion të ruajtjes, zhvillimit, mbrojtjes e konservimit të elementeve të rëndësishme të kësaj trashëgimie, ndër vlerat më të larta të

² Takim pune për reformën në sistemin e trashëgimisë kulturore https://www.facebook.com/Ministria-e-Kultur%C3%ABs-1426548810890957/photos/?tab=album&album_id=1708148609397641

kombit tonë. Këtu mund të kujtojmë se në disa raste gjendemi edhe përpara vendimesh apo urdhëresash të cilat ndodh të mos jenë efektive në masën e duhur për efekte kushtëzimi nga kjo prapavijë ligjore. Kjo nuk do të nënkuptonte dështimin apo cilësinë e ligjit aktual, por nevojën për rishikim dhe riformulim pasi rëndom nuk gjen zbatim apo nuk respektohet në masën e duhur. Gjithashtu ndodh të krijohen konfuzione apo debate pasi udhëzimet ligjore mund të jenë të paqarta dhe hasin vështirësi në fazën e aplikimit.³

Për sa i përket përcaktimeve të detyrimeve të pushtetit vendor, lidhur me mbrojtjen dhe ruajtje e trashëgimisë kulturore në territorin e tyre nuk janë të qarta, gjë që në disa raste ka çuar edhe në përplasje të institucioneve të kulturës në nivel qendror apo atyre të vartësisë, në përplasje me institucionet e pushtetit vendor, siç do të ishte dhe rasti i disa muajve më parë për restaurimin e Piramidës, në Tiranë me status – monument kulture i kategorisë së dytë. Sipas ligjit përkatës në Shqipëri Trashëgimia kulturore materiale dhe jo materiale, e luajshme dhe e paluajshme në Shqipëri u adresohet tre pronarëve të ligjshëm që janë: Shteti, Institucionet Fetare dhe personat private. Prandaj përpos shumë ndryshimeve të nevojshme, duhen ri parë edhe përcaktimet e qarta të kompetencave dhe të përgjegjësive të institucioneve brenda vetë sistemit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, gjë që në disa raste ka sjellë edhe përplasje midis tyre.

Një tjetër rast për rishikim që kërkon reformimin e këtij kuadri ligjor është nevoja për të siguruar harmoninë e këtij ligji me ligjet e tjera që lidhen me buxhetimin, turizmin, planifikimin e

territorit, mbrojtjen dhe aplikimin konkret të sanksioneve në rastet e kundërvajtjes etj. Kështu që lind nevoja edhe për forcimin e mekanizmave të penalizimeve ndaj atyre që dëmtojnë trashëgiminë kulturore. Në ligjin aktual gjenden disa formulime që janë pothuajse të pazbatueshëm, ndaj duhet bërë një përcaktimi i masës së gjobave në nivele më të larta, për të ndëshkuar realisht krimin ndaj veprave të trashëgimisë kulturore si dhe të sigurohet struktura e duhur organizative për monitorimin dhe inspektimin në terren të rasteve abuzive. Aktualisht dimë se masat ndëshkimore aplikohen nga Drejtoritë Rajonale të TK nëpër rrethe sipas kontestimeve përkatëse apo të rastit. Prandaj do të ishte e nevojshme mundësia e krijimit të një strukture e cila do të mund të përfshinte dhe një inspektorat të çështjeve të trashëgimisë i cili mund të atashohej MK, DRK-ve në rrethe, puna e të cilëve do të konsistonte në terren me kontrole periodike dhe raportime të herë pas herë. Do të ishte i nevojshëm mbajtja në vëzhgim e terrenit në shumë aspekte, pasi edhe në rastet kur ka pasur kontestime për abuzime, masat ndëshkimore nuk janë aplikuar, kjo për sa i përket çështjes së gjobave. Abuzimet mund të jenë nga me të ndryshmet e të pafundmet, nga me të parëndësishmet deri tek ato më fatale por kjo nuk do të thotë që kjo pjesë e ligjit të qëndrojë e paralizuar dhe të papërgjegjshmit të mos ndëshkohen, sikurse ka ndodhur deri më sot duke filluar nga rastet më të lehta deri tek çështjet e trafikimit të veprave të artit apo të trashëgimisë kulturore janë inekzistente në "publik", aq sa shumëkujt, ndodh që nuk i shkon mendja kurrë se çfarë mund të ndodhe realisht dhe sa të rënda janë këto akte në dëm të ruajtjes së pasurisë kulturore dhe në funksion të humbjes së saj. Prandaj mund të themi, se

³ Ligji për Trashëgiminë Kulturore Shqipëri-nr. 9882-
http://www.bksh.al/Pershkrimi_ligje9.html

në realitetin shqiptar, një nga problemet kryesore është mosveprimi i ligjit ndaj dëmtuesve.

Në kuadrin e kësaj linje të mendimit, mund të themi se është shumë e paqarte edhe situata e kontrollit të tregut të materialeve kulturore edhe pse jo të listuara në listën kombëtare të trashëgimisë. Është fjala për të gjitha at subjekte "antikuarësh" ose "vjetërsirave" "origjinale", pasi ndodh që mes mallrave të këtyre subjekteve të gjenden dhe sende të çmuara të cilat mund të kalojnë pa u "vlerësuar" dhe të zhduken edhe jashtë territorit të Shqipërisë. Ndaj një emergjencë në këtë fushë është "firoja" e madhe e materialit vlera kulturore e çfarëdo natyre qoftë dhe pa dallim përmasash apo rëndësie (te regjistruara/certifikuara). Këtë e kupton edhe përgjatë një hulumtimi të zakonshëm në pazaret e qyteteve historike të cilat tashmë po tregtojnë në masë prototipe të riprodhuara keq të objekteve tradicionale po aq sa edhe mallra të importuara që nuk janë pjesë origjinale apo riprodhime të modeleve të prodhimit kulturor vendas sipas traditës.

MINISTRIA E MBROJTJES

Brenton KOTORRI, MSc

1- Kodheli vetëledhatohet në Hamburg

Pranvera e tretë e qeverisë Rama nuk mund të mos shoqërohej me shoppingun sezonal. Skandali në fjalë u raportua gjerësisht prej disa mediave gjermane dhe mediave shqiptare gjithashtu. Ministria Kodheli gjatë një vizite zyrtare në Gjermani, ka përdorur eskortën shtetërore për të bërë Pazar personal. Gazeta e përditshme gjermane, "Hamburg Morning Post" i ka kushtuar një shkrim një shëtitje të ministres Mimi Kodheli në dyqanet e famshme në Hamburg.

Tabloidi gjerman shkruan se, Kodheli ka shkuar në dyqanet e zonës Alsterhaus, duke kaluar plot të dy orë atje, por nuk jep informacion se sa mund të ketë shpenzuar ministria shqiptare. "Tri limuzina me drita të ndezura, një Mercedes S-Class dhe një automjet i policisë ushtarake. Vizitë shtetërore? Jo, ministria shqiptare e Mbrojtjes, Mimi Kodheli po bën pazar. Pas vizitës në Berlin, Kodheli shkoi në Hamburg me helikopter. Në këtë qytet, ministria e Mbrojtjes ka bërë dy orë shopping në dyqanet VIP të Alsterhaus",- shkruan "Hamburg Morning Post"¹. Në gazetë thuhet se, Mimi Kodheli që nga e Hëna ndodhet në Gjermani për të takuar homologen gjermane ku diskutohet për situatën në Ballkan dhe marrëdhëniet me Rusinë². Më pas ajo është parë me Hummer dhe makina të tjera luksoze nëpër dyqanet e kushtueshme VIP të Alsterhaus. Gazetari është përpjekur të marrë vesh nga shitësit për shpenzimet që ka bërë ministria, por nuk ka mundur të zbulojë diçka të tillë. Ajo që ka çuditur të gjithë

¹ Hamburg Morning Post
<http://www.mopo.de/hamburg/staatsbesuch-aus-albanien-verteidigungs-ministerin-shoppt-im-alsterhaus-24042928>

² Lapsi.al <http://www.lapsi.al/node/30302#.V0oX-5F9602>

është fakti se Mimi Kodheli shoqërohej nga makina të shumta luksoze.

Ndoshta ajo mund ta ketë menduar si një shpërblim të vogël për veten pas suksesit në parlament të miratimit të ligjit për faljen e detyrimeve të pensioneve të ushtarakëve³, a thua se shteti i kishte trajtuar aq mirë deri më tani. Aktiviteti privat i ministres Kodheli që krekosej në restorantet e luksit dhe dyqanet e shtrenjta të Gjermanisë⁴ tërhoqi vëmendjen e gjermanëve, jo se ata nuk janë mësuar me njerëz të pasur, por ngase nuk janë mësuar me paseriozitet dhe abuzim të tillë me detyrën. Ministria Kodheli, nuk ka hezitur ta ndajë këtë shëtitje private me shpenzime shtetërore as në mediat sociale, duke shprehur një lumturi të tejskajshme pa kaluar as 40 ditë nga varrosja e dy efektivëve të FA që e humbën jetën para syve të saj. Tragjedi, për të cilën me mbylljen e hetimeve deklaruan që të paktën nuk e ka fajin Shtabi i FA dhe as ministria⁵, por se çfarë ndodhi në të vërtetë duket se nuk kanë ndërmend ta hetojnë.

Arroganca e shfaqur hapur duket që kur i drejtohet koleges së vet gjermane me etiketimin "mikesha ime", një gjest që e bëjnë përgjithësisht vetëm politikanë të dorës së dytë të botës së tretë për t'i rritur rëndësinë vetes; ndërkohë që as njerëz të rëndomtë të cilëve u lejohet mungesa e kortezisë nuk krenohen se ushqehen për drekë e darkë me bazë peshku sikurse bën ministria jonë⁶. Me një skandal të tillë, në

³ Falen detyrimet për ushtaraket
<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/neesroom-2/1731-miratohet-ligji-per-faljen-e-detyrimeve-te-ish-ushtarakeve>

⁴ Selfie e ministres <http://www.mapo.al/2016/05/kjo-eshte-ina-dhe-eshte-eskorta-me-e-miregafa-e-rende-e-ministres>

⁵ Deklarata për mbylljen e hetimeve
<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/neesroom-2/1727-2016-04-28-14-04-36>

⁶ Axhenda e vizitës
<http://www.mapo.al/2016/05/portali-gjerman-mopo-kodheli-pas-shoppingut-peshk-per-dreke-dhe-darke>
dhe <http://www.gazetadita.al/axhenda-ky-ishte->

perëndim ministri dorëhiqet, ose minimalisht kërkon falje. Shembulli i një standardi të lartë për këtë, është ish-ministri australian i Pushtetit Lokal, i cili vetëm pse u akuzua për fjalor vulgar nga një kamariere në Hong Kong, dha dorëheqjen për të ruajtur dinjitetin e qeverisë dhe të vendit të vet⁷. Por ky nuk mund të jetë kurrsesi rasti i Kodhelit ajo nuk është australiane, dhe as ne në fakt.

2- Kush e mbron shtetin?

Ministria e Mbrojtjes ka përjetuar edhe një turp tjetër gjatë muajit maj. Një pakujdesi e pafalshme ka bërë të mundur që Ministria e Mbrojtjes të miratojë pa teklif një marrëveshje qiradhënieje për Kombinatin Mekanik të Poliçanit ndaj një kompanie Bullgare që po hetohet për lidhje me krimin e organizuar ndërkombëtar. Pas një kërkesë për të drejtë informimi nga ana e BIRN, Ministria e Mbrojtjes tha se i është përgjigjur kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë duke deklaruar se ajo është dakord me dhënien me qira. BIRN mësoi gjithashtu se plani është që kombinati të jepet me qira me vlerën simbolike prej 1 euro, si pjesë e deklaratave të qeverisë për nxitjen e investimeve në ekonominë shqiptare. Por të dhëna të siguruara nga BIRN tregojnë se kjo kompani është e lidhur me një prej figurave më famëkeqe të kimit të organizuar në Bullgari. BIRN ka mësuar gjithashtu se përveç kompanisë Bullgare, dy kompani të mirënjohura amerikane që operojnë në fushën ushtarake ishin të interesuara për marrjen në shfrytëzim kombinatit të Poliçanit, por kërkesat e tyre janë hedhur poshtë. Nuk

[programi-i-ministres-kodheli-gjate-vizites-ne-gjermani/](http://www.programi-i-ministres-kodheli-gjate-vizites-ne-gjermani/)

⁷ Doreheqja e ministrit Australian

<http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/australiaandthepacific/australia/12072336/Australian-government-minister-resigns-over-incident-in-Hong-Kong-bar-èith-female-public-servant.html>

janë dhënë sqarime pse u preferuan bullgarët përballë amerikanëve⁸.

3- NATO

Lajme relativisht të mira vijnë nga NATO. Relativisht, duke mbajtur parasysh se nuk ka asnjë studim të deritanishëm lidhur mbi bilancin kosto – përfitim të anëtarësimit tonë në aleancë. Sidoqoftë, së shpejti do të ngrihet në Shqipëri një Qendër Ekselence e NATOs⁹. Asambleja Parlamentare e NATOs, një organizim periferik ndaj aleancës në vetvete, por me përfaqësues të mesëm të vendeve anëtare u mblodh në Shqipëri në fund të muajit, pa gjasa për ndonjë produkt ndryshimsjellës. Së fundmi, në kuadër të NATOs¹⁰, një grup ushtarësh shqiptarë kanë realizuar me sukses një stërvitje të detajuar në Poloni¹¹. Për asnjë prej këtyre ngjarjeve, ministria nuk informon për të mirat dhe përfitimet që ka Shqipëria. Gjë që ne e kërkojmë të ndodhë sa më shpejt për një publik më të mirinformuar në përmbajtje dhe jo në formë.

⁸ Reporter.al <http://www.reporter.al/kompania-me-lidhje-me-krimin-e-organizuar-kerkon-me-qira-kombinatin-armeve/>

⁹ Qendra e studimeve NATO

<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/neesroom-2/1754-ne-shqiperi-do-te-ngrihet-nje-qender-ekselente-e-nato>

¹⁰ Asambleja Parlamentare

https://www.youtube.com/èatch?v=Ègs_Z5_NTec dhe <http://www.balkanèeb.com/site/shqiperia-mirepret-asablene-parlamentare-te-nato-s-ja-çfare-u-diskutua-ne-diten-e-pare/>

¹¹ Stërvitja në Poloni

<http://www.mapo.al/2016/05/video-krenohet-kodheli-keta-jane-zemerluanet-qe-po-na-nderojne>

MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

Ingrid XHAFA, MA

1-Si mbrohen fëmijët ?!

Prej disa muajve, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka nisur një fushatë në gjithë vendin për mbrojtjen e fëmijëve. "Unë Mbroj Fëmijët", është kthyer tashmë në një fushatë të madhe sensibilizimi, e cila ka përfshirë edhe njësitë specifike brenda të gjitha bashkive në vend, me qëllim adresimin e problematikave të ndryshme në lidhje me fëmijët¹. Edhe më herët, në [raportin e muajit Prill](#), është evidentuar që qasja e Ministrisë ndaj një çështje kaq e rëndësishme si mbrojtja e fëmijëve, mbështetur kryesisht në fushata ndërgjegjësimi, është e pamjaftueshme dhe ineficente. Për fat të keq, pak javë mbas këtij konstatimi u shënuar një ngjarje e rëndë në Qendrën Rezidenciale të Fëmijëve 6-18 vjeç në Shkodër, e cila dëshmon për mënyrën jo efikase të mbrojtjes së fëmijëve. Prokuroria e Shkodrës ka konstatuar se është ushtruar dhunë fizike dhe ka ndodhur abuzim seksual mbi 3 vajza të mitura jetime, rezidentë të Qendrës për Fëmijë në qytetin e Shkodrës. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë me nenin 54 të saj përcakton se është detyrim shtetëror garantimi i mbrojtjes së fëmijëve në përgjithësi dhe atyre të cilëve iu mungon kujdesi prindëror në veçanti. Fëmijët kanë të drejtën të jenë të mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi apo përdorimi për punë. Pra, jo vetëm që shteti shqiptar ka dështuar të

¹ Artikull mbi fushatën sensibilizuese të MMSR-së në Lushnje: <http://www.ata.gov.al/autobusi-une-mbroj-femijet-ne-lushnje/>

garantojë mbrojtjen e të drejtave themelore të këtyre fëmijëve, por ai vetë është bërë përgjegjës i dhunës sistematike fizike e seksuale që është ushtruar për një kohë të gjatë në një Qendër Rezidenciale të Fëmijëve në Shkodër.

Fill pas ngjarjes së rëndë të shënuar, ka nisur një lojë pingpongu mes institucioneve vendore dhe atyre qendrore mbi përgjegjësinë institucionale të secilit. MMRS-ja fajëson Bashkinë e Shkodrës si përgjegjësen kryesore për mos administrimin e kujdesshëm të Qendrës dhe në mos marrjen e masave ndaj 8 raporteve rekomanduese që Shërbimi i Social i Shtetit (institucion varësie i ministrisë) ka hartuar pas problematikës që ka konstatuar vitet e fundit. Nga ana tjetër, Bashkia e Shkodrës ka argumentuar se i mungojnë kapacitetet e duhura për mirë-administrimin e qendrave të tilla, që nga ana e saj i sheh si institucione problematike dhe që duhen zhdukur me kalimin e kohës. Ministri Klosi ka deklaruar se përgjegjësia e vetme e institucionit që ai drejton është monitorimi, i cili sipas tij është kryer me përpikëri, por ka qenë Bashkia, institucioni, i cili nuk ka marrë masat e nevojshme më pas².

Në fakt, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është po aq fajtores për situatën e ndodhur, sa edhe Bashkia e Shkodrës, po aq sa edhe çdo institucion tjetër shtetëror që merret me përkujdesjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Dhe këtu nuk bëhet fjalë për faje morale, por dështim të plotë institucional dhe ligjor. Kështu, sipas ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në nenin 24, është cilësuar se

² Për më tepër, shih debatin televiziv në emisionin Top Story:: <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=327033>

bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, ku ndër të tjera përfshihen edhe fëmijët. Megjithatë, neni 13 i të njëjtit ligj parashtron se "për zbatimin e normave e të standardeve kombëtare, të përcaktuara në legjislacionin përkatës, ministritë, sipas fushave të përgjegjësive, monitorojnë veprimtarinë e organeve të njëjste të vetëqeverisjes vendore". MMSR ka dështuar në misionin e saj në marrjen e masave ndaj problemeve, që argumenton se ka identifikuar prej kohëve. Agjencia Shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, krijuar me ligjin nr. 10347, datuar më 04.11.2010 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës" ka funksion ndëshkues ndaj subjekteve të cilat shkelin dispozitat e ligjit. Qendra rezidenciale e Fëmijëve në Shkodër ka shkelur disa standarde të shprehura në VKM Nr. 659, datuar më 17.10.2005 "Për standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale" dhe nuk është ndëshkuar sipas ligjit. Ministria ka dështuar në rolin e saj për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat e fëmijëve në Republikën e Shqipërisë dhe masat e marra mbas ndodhjes së skandalit janë një dëshmi plotësuese e kësaj.

Kështu, pas skandalit, Ministria ka ndërmarrë një plan të përbashkët pune me të gjitha institucionet e varësisë, ato qendrore, vendore dhe organizata të shoqërisë civile. Disa nga këto masa përfshijnë ngritjen e një task force, e cila do të monitorojë performancën e institucioneve të kujdesit për fëmijët, vlerësim të cilësisë dhe aftësisë të të gjithë personelit; mobilizimit të një sërë aktorësh publik, ndryshim të praktikave monitoruese dhe vlerësuese, etj. Ministria, e cila ka muaj që ka ndërmarrë një fushatë për mbrojtjen e fëmijëve, merr një nismë

monitorimi dhe vlerësimi të kushteve ku fëmijët pa kujdes prindëror qëndrojnë, vetëm pas një skandalit të ndodhur. Pra MMRS-ja ndjek një politikë *post factum* në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve. Ajo fillon aksione veprimi pasi plasi skandali me përmasa publike. Gjithashtu në masat që rekomandohen nga Ministria lidhen me 2 ndryshime të rëndësishme ligjore si: i) ndryshimi i ligjit për vetëqeverisjen vendore, ku kërkohet që funksionet e shërbimeve sociale ti kryejnë institucionet qendrore pasi bashkitë s'kanë kapacitetet e duhura dhe ii) mbyllja përfundimtare e qendrave rezidenciale të kujdesit për fëmijë dhe shndërrimi i tyre në qendra ditore. Fakti që Ministria propozon të bëjë amendime në ligjin e vetëqeverisjes vendore, i cili është hartuar vetëm pak muaj më parë (me ndryshimet që erdhën edhe si pasojë e reformës territoriale-administrative) dhe fakti që vetëm pak javë më parë shndërroi qendrat e kujdesit social në qendra të pritjes së emergjencës, tregon se programet dhe politikat e ndërmarra janë të paqarta, me vizion të cunguar dhe me mungesa bashkërendimi institucional.

2-Miratohet Plani Kombëtar i Veprimit për LGBTI-të

Është miratuar më 25 Maj 2015 Plani Kombëtar i Veprimit (PKB) për LGBTI-të, një dokument politik i qeverisë shqiptare, në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020. Ky Plan synon mosdiskriminimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Shumica e objektivave të shprehura në strategji lidhen me parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor nëpërmjet ndërgjegjësimit të shoqërisë dhe fuqizimit të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të LGBTI. Buxheti i Shtetit mbulon

vetëm 39.8% të kostove të përgjithshme për zbatimin e PKV për një periudhë 5 vjeçare. Ndërkohë që fondet e angazhuara nga donatorët për vitin 2016 janë të papërfillshme në raport me nevojat për financime, Ministria duhet të angazhohet të mobilizojë fonde të mjaftueshme për realizimin e objektivave strategjike që ka parashtruan në PKV. Hartimi dhe zbatimi i këtij plani lidhet ngushtë me detyrimet që rrjedhin nga nënshkrimi i një sërë dokumentesh ndërkombëtare, ku përfshihet dhe Deklarata e përbashkët e Ministrave të rajonit në forumin IDAHO 2015.

Pavarësisht miratimit të PKV-së, ka nisur një debat i gjerë publik për një ndryshim të mundshëm në Kushtetutë, i cili do të shtojë në nenin 18 të Kushtetutës, pika 2 se ndër të tjerat, diskriminimi ndalohej edhe për *shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor*, një ndryshim i propozuar nga Komisioni i Posaçëm i Reformës në Drejtësi dhe i rekomanduar edhe nga Bashkimi Europian në progres-raportin e vitit 2015-të³. Debati publik, i cili ka përfshirë edhe deputetë dhe anëtarë të shoqërisë civile, argumenton se ky ndryshim në kushtetutë i hap rrugën lejimit të martesave brenda të njëjtës gjini. Për momentin, qeveria shqiptare (përfshirë MMSR) është angazhuar të përforcojë legjislacionin në mbrojtje të dinjitetit dhe kundër diskriminimit, në përputhje me dokumentet dhe konventat ndërkombëtare ku merr pjesë dhe duket se ndryshimi nuk ka funksion tjetër të dyfishtë, që mund të lidhet me lejimin e martesave brenda të njëjtës gjini. Në rast se qeveria shqiptare

do të bënte një ndryshim të tillë do ti duhej të ndryshonte një sërë ligjesh të tjera, përfshirë edhe Kodin e Familjes, ku sipas nenit 7 të Kodit të Familjes, "*martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje*". Megjithatë, në kushtet kur ekzistojnë ende praktika të pabarazitë dhe mungesës së të kuptuarit të të drejtave të njeriut të personave LGBTI në shoqëri, ndryshime të tilla ligjore do të kishin shkallë të ulët implementimi dhe do të mund të prodhonin efekte të kundërta me qëllimin parësor të ligjit. Prandaj rekomandohet, që para se të ndodhin ndryshime të tilla strukturore, ka nevojë të shihen rezultatet e fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit të shoqërisë në këtë drejtim.

³ Komisioni Europian, Progres Raporti 2015 për Shqipërinë fq, 16. Aksesuar për herë të fundit më http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_albania.pdf

MINISTRIA E MJEDISIT

Flutura GJANA, MSc.

1- Mbetjet Urbane

Mbetjet Urbane vazhdojnë të mbetem një shqetësim për sa i përket cilësisë së mjedisit i cila ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së popullsisë që jeton në territorin shqiptar. Problem i cili është shumë më i zhvilluar në qendrat e mëdha urbane si Tirana, Elbasani, Durrësi, Vlora, Shkodra etj. Mungesa e sistemeve të grumbullimit dhe atyre të trajtimit të mbetjeve urbane janë dy shkaqet kryesore të kësaj problematike.

Situata pritej të përmirësohej me miratimin e "Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve"¹ dhe "Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve"². Si plani, ashtu edhe strategjia u miratuan³ me Vendim të Këshillit të Ministrave më 9 prill të vitit 2011. Por, impaktet pozitive që priteshin të dukeshin që në 5 vjeçarin e parë të implementimit të kësaj strategjie nuk duken gjëkund.

Në strategji citohet se brenda vitit 2015 duhet të arrihet:

- *Të realizohet mbledhja e mbetjeve sipas kategorive: letër, metal, plastike dhe qelq deri në 2015*

¹ Strategjia Kombëtare Shqiptare mbi Mbetjet (<http://www.riciklimi.al/uploads/documents/424728857-1351123004.pdf>)

² Planit Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve (<http://www.riciklimi.al/uploads/documents/1419094604-1351202813.pdf>)

³ Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë (http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2011/PDF-2011/36-2011.pdf)

- *Të arrihet menaxhim i mbetjeve, parandalim i hedhjes së paautorizuar së mbetjeve dhe jo të miratuara nga autoritetet lokale deri në 2015,*
- *Sasia e mbetjeve të mbledhura nga autoritetet lokale të cilat janë ricikluar apo përzier të rritet në 25% deri në vitin 2015,*
- *Të ndërtohet një impiant djegieje në bashkëpunim me industrinë deri në fund të vitit 2015*
- *Konvertimin e landfilleve në një metodologji të verifikueshme deri në vitin 2015,*

Secili nga ne mund të thotë me kompetencë të plotë që nuk është përbushur asnjë nga pikat e lartpërmendura. Ku qëndron vlera e miratimit të planeve apo strategjive(?) kur asnjë nga këto nuk merret "seriozisht" nga institucionet tona dhe drejtuesit e tyre.

Më e keqja është se ne akoma nuk e dimë se me çfarë kemi të bëjmë. Kjo vjen si pasojë e mungesës së të dhënave të përditësuara për sasinë dhe llojin e mbetjeve. Në kushtet, kur përballemi me mungesë të të dhënave çështja bëhet edhe më e rëndë. Diskutimi për menaxhimin e mbetjeve nuk ka më vlerë për politika që drejtojnë menaxhimin sepse është e pamundur të gjenerohen dhe të implementohen politika në mungesa të një sistemi kombëtar të raportimit standard. Me doemos duhet të analizohet se sa kemi për të menaxhuar për të pasur politika të drejta të menaxhimit të mbetjeve.

Problemi i menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri nuk vjen si mungesë e ligjeve (që natyrisht kanë nevojë të përmirësohen edhe më tej), por si mungesë e planifikimit të burimeve

njerëzore, financiare dhe investimeve në infrastrukturë, si mungesë e kapaciteteve teknike, e komunikimit të dobët midis qeverisë lokale dhe qendrore mbi çështjet e mbetjeve, bashkëpunimit të dobët midis autoriteteve lokale dhe kompanive private, si dhe mungesës së infrastrukturës së nevojshme për t'i mbledhur dhe për t'i përpunuar ato.

Politikat mjedisore në Shqipëri dhe vetë realiteti shqiptar, po përballen me një sërë problematikash dhe shqetësimesh të dukshme. Shqipërisë, përkatësisht qeverisë dhe Ministrisë së Mjedisit i mungon vizioni afatgjatë për të menaxhuar çdo aspekt që lidhet me mbetjet urbane. Për ndërtimin e një Shqipërie të qëndrueshme Ministria duhet të ndjekë objektivin që ka vendosur që të mund të sigurohet përparimi drejt menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve.

I rikujtojmë Ministrisë së Mjedisit që sipas Direktivës 1999/31/KE⁴, shtetet anëtare detyrohen të reduktojnë sasinë e mbetjeve biodegradueshme me 35% deri në 2016.

⁴Council Directive 1999/21/EC
(<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:1999:182:0001:0001:EN:PDF>)

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Megi LLUBANI, MSc

1- Shqipëria si oaz kriminelësh

Gjatë muajit maj u bëmë dëshmitarë të një skenari "quasi" mafioz në mes të kryeqytetit. Vrasja e shumëpërfolur e Elton Cicos nga Jani Alia, dy persona me të shkuar e të tashme kriminale që shëtisnin të lirë e të pa shqetësuar në rrugët e Shqipërisë solli në vëmendje disa fakte shqetësuese për punën e Policisë së Shtetit.

- Fakti numër 1: Viktima kishte tentuar të paktën dy herë gjatë këtij viti të ekzekutonte ekzekutuesin e tij. Në të dy rastet policia ka pasur dijeni dhe madje ka marrë në pyetje Jani Alinë, por asgjë nuk ka ndodhur.¹
- Fakti numër 2: Jani Alia, një person me rrezikshmëri të lartë shoqërore, është arratisur nga një burg i Greqisë ku ishte i dënuar me burgim të përjetshëm ku është futur në Shqipëri për të vijuar një jetesë normale, e madje të ngrinte edhe një biznes.² Si është e mundur që

një person me precedent penal, i shpallur në kërkim dhe arratisur nga vendi fqinj të mund të bënte një jetë të qetë në Shqipëri? Vërtetë nuk kishte dënim nga gjykatat shqiptare, por a nuk dëgjojmë shpesh ministrinë të lavdërohet për bashkëpunimin e shkëlqyer me partnerë të tjerë e në rajon? Si ka mundësi që edhe pse policia e shtetit ka qenë në kontakt me këtë person pas atentateve kundër tij, nuk i është bërë një "background check"?

- Fakti numër 3: Ministri Tahiri me të drejtë është përpjekur gjatë mandatit të tij të krijojë një imazh të ri mbi policinë e shtetit dhe punën e saj në terren. Si ka mundësi që në faqen zyrtare të ministrisë së punëve të brendshme nuk ka asnjë deklaratë për këtë rast dhe asnjë deklaratë mbi arsyet përse një oficer policie gjendej në të njëjtën tavolinë me një person me të shkuar kriminale minimalisht në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike?

Ministria nuk ka ofruar asnjë shpjegim për asnjë prej këtyre fakteve, që qartësisht flasin kundër punës së efektivëve të policisë. Çfarë do të ndodhë me ekzekutuesin pasi të kapet? Do mundet të arratiset sërish sikundër nga Greqia? Nuk është hera e parë që në njoftimet zyrtare të ministrisë së brendshme të renditen operacionet e suksesshme dhe personat e arrestuar, por asnjëherë

¹ Balkanëeb, 24 maj 2016, Historia e hakmarrjes mes Elton Cics dhe Jani Aliajt: tentativat e dështuara për të eliminuar njëri-tjetrin, online: <http://www.balkanëeb.com/site/historia-e-hakmarrjes-mes-elton-cices-dhe-jani-aliajt-tentativat-e-deshtuara-per-te-eliminuar-njeri-tjetrin/>

² Nikoleta Kovaci, 26 maj 2016, Jani Alia: I dënuari përjetë në Greqi njihej nga policia shqiptare, Gazeta

shekulli, online:

<http://www.shekulli.com.al/p.php?id=434807>

nuk jepet llogari për raste kaq të rënda që vënë në pikëpyetje sigurinë publike në Shqipëri.

2- Mania e përgjimeve

Alarmi i dhënë nga opozita dhe kryetari i SHISH për një pajisje përgjimi që ka hyrë në mënyrë të paligjshme në Shqipëri shkaktoi një valë spekulimesh, akuzash dhe kundërakuzash që kulmuan në raportimin para Komisionit të Sigurisë të Ministrit të Punëve të Brendshme Z. Tahiri, Shefit të Policisë së Shtetit, Z. Haki Cako, Kryeprokurori Z. Adriatik Llalla dhe Kreu i SHISH Z. Visho Ajazi. Të katër palët raportuan para deputetëve në lidhje me akuzat dhe u ftuan të japin sqarime mbi pretendimet e ngritura nga media dhe opozita për këtë pajisje të dyshimtë që është futur në territorin e Shqipërisë nga Italia dhe që pretendohet se është përdorur nga Interforca italiane për të zhvilluar një trajnim.³ Sikundër ndodh rëndom në raportimet para kuvendit dhe ligjvënësve nuk u ofrua ndonjë qartësim i asaj që kish ndodhur. Kjo ishte më e dukshme në përgjigjet e kreut të forcave blu dhe ministrit të punëve të brendshme. Veçanërisht ky i dyti mbajti një leksion aspak të nevojshëm mbi ristrukturimin e forcave të policisë, vendosjen në punë të Akademisë së Policisë dhe

ndryshimin e imazhit të kësaj të fundit tek publiku. Përgjatë kohës së tij si ministër Z. Tahiri e ka përdorur si kalë beteje ndryshimin e imazhit të policisë së shtetit dhe afrimin e tij me komunitetin. Ndërkohë që ka pasur arritje në këtë drejtim, APPA e ka vënë në dukje edhe në raportet e kaluara që arritjet kanë qenë më tepër estetike se thelbësore. Është në fakt për të ardhur keq që ministri ende i referohet gjendjes së mjerueshme në të cilën ndodhej policia e shtetit, një mjerim i trashëguar nga paraardhësit e tij dhe qeverisja e opozitës. Në vend që ministri të merret me arritjet e këtyre tre viteve të mandatit të tij i cili ka hyrë në vitin e fundit, ai fatkeqësisht ende merret me dështimet e katër viteve më parë. Prokuroria ka nisur hetimet për të zbardhur ngjarjen. Ndërkohë që presim rezultatet e hetimit, urojmë që kjo të mos jetë shfaqja politike e radhës.

³ Eva Hoxha, 18 maj 2016, E Plotë/ Zbardhen debatet për përgjimet në Komisionin e Sigurisë, gazeta Shekulli, online: <http://www.shekulli.com.al/p.php?id=431497>

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Sokol KONDI, MSc

1- Zbulimi/Konsullata në Milano, skandali erdhi nga Ministri dhe MPJ

Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë në Milano vazhdon të jetë epiqendra e skandaleve të shërbimit të jashtëm shqiptar. Duket sikur në këtë konsullatë ka një vorbull e cila i përthith si me magnet problemet. Aq e vërtetë është kjo, sa që nuk mjaftoi që tashmë ish-Konsullja e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë të kapej në flagrancë nga një filmim me kamera të fshehtë duke marrë një ryshfet prej 1 mijë eurosh për lëshimin e një certifikatë të falsifikuar martesore, për qëllime "humanitare" siç do të shprehej vetë Znj. Çobanaj.¹ Në fakt skandali me Znj. Çobanaj është më i hershëm dhe nuk përfshin vetëm këtë të fundit, por në radhë të parë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe direkt ministrin Ditmir Bushati.

Zbulojmë se MPJ dhe ministri, me emërimin e Znj. Çobanaj si Konsulle e Përgjithshme në vitin 2014 kanë bërë një shkelje të rëndë ligjore, duke rikthyer në detyrë një funksionare shtetërore të shkarkuar më parë nga detyra pikërisht për të njëjtin lloj shkeljesh dhe si për ironi të fatit pikërisht në të njëjtën konsullatë. Sipas CV-së së publikuar nga vetë Znj. Çobanaj, kjo e fundit në jetëshkrim thotë se ka qenë: "*Punonjëse Finance dhe Sekretare pranë Konsullatës Shqiptare në Milano*" në vitet 2000-2003.² Nga burime

¹ Artikull, Ish-konsullja Çobanaj shpjegon mitmarrjen <http://www.mapo.al/2016/03/ish-konsullja-e-milanos-jam-e-pasur-e-dhashe-per-humanizem-certifikaten-ndocaj-te-paguaj-dritat>

² Artikull ku citohet jetëshkrimi i publikuar nga Ish-Konsullja e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë në Millani, <http://telegraf.al/bota-rajoni/si-e-ktheu-diplomatja-cobanaj-konsullaten-e-milanos-ne-shtepi-te-shqiptareve>

konfidenciale por të besueshme për APPA, të rangut të ish-funksionarëve të lartë në MPJ, mësojmë se në fundin e muajit tetor 2003, Luljeta Çobanaj është shkarkuar nga detyra me urdhër të Ministrisë, pas verifikimit që i është bërë punës së saj, gjë nga e cila kanë rezultuar shkelje të ndryshme, që dyshohet se janë të njëjta apo të ngjashme me shkeljen e rëndë që solli shkarkimin e Znj. Çobanaj disa muaj më parë.

Por, ndërkohë që mitmarrja e ndodhur në muajin shkurt 2016 ngarkon me përgjegjësi vetëm ish-Konsullen e Përgjithshme, gjë për të cilën ajo u ndëshkua, emërimi i saj në detyrë është përgjegjësi direkte ligjore e Ministrit të Punëve të Jashtme, i cili i propozon Konsujt Kryeministrit, që më pas i emëron. Nuk ka rëndësi, në rast se Z. Bushati dhe MPJ e dinin apo nuk e dinin se Znj. Çobanaj ishte përjashtuar më parë nga shërbimi i jashtëm shqiptar, sepse në të dyja rastet përgjegjësia direkte bie mbi ta. Është një dështim i të gjitha hallkave institucionale të MPJ, nga niveli më i poshtëm e deri tek ai më i lartë, në rast se nuk e kanë ditur një gjë të tillë. Dhe është një shpërdorim detyre në rast se e kanë bërë qëllimisht një gjë të tillë. Në një vend normal, kjo çështje nuk mund të përfundonte kurrsesi vetëm me shkarkimin e ish-Konsulles.

2- Bushati, nga korrupsioni te militantizmi

Por cila është përgjigja që i ka dhënë Tirana zyrtare amullisë së krijuar me Konsullatën e Përgjithshme në Milano, ku nga burime jozyrtare, mësojmë se janë shkarkuar i gjithë personeli, bashkë me Znj. Çobanaj (madje është shkarkuar edhe shoferi i Konsullatës).

Burime zyrtare të shërbimit diplomatik shqiptar na njoftojnë se në pritje të emërimit zyrtar, ministri Bushati ka caktuar për momentin Konsull në Milano, Konsullin e Barit, Z. Robert Hoxha. Ky i fundit është kryetari i Partisë Socialiste të Barit, gjë të cilën e kemi denoncuar edhe muajt e kaluar, çka përbën një shkelje ligjore.

Përveç kësaj, shkelje ligjore përbën fakti që MPJ e ka pranuar pa konkurs në Shërbimin e Jashtëm Z. Hoxha dhe detyrën e parë në këtë shërbim i ka caktuar direkt atë të Konsullit, pa respektuar shkallët e karrierës.

Le të presim pa paragjykuar se cili do të jetë Konsulli i ri i Përgjithshëm, i emëruar zyrtarisht nga Tirana, por sidoqoftë zgjidhja "ad-interim" nga një e korruptuar te një militant partiak në Konsullatën e Milanos, nuk është maksimumi që mund të bënte MPJ dhe ministri i Jashtëm, aq më tepër kur bëhet fjalë për caktimin e një Konsulli me nivel bazë njohurish të mbështetura vetëm në një diplomë Bachelor, ndërkohë që ligjet e Administratës Publike shqiptare, kërkojnë minimalisht një diplomë Master, për nivelet e Drejtorëve dhe të përfaqësuesëve të lartë të Shqipërisë.

3- Situatë komike me Konsullatën në Janinë

Jo të gjithë ambasadat dhe konsullatat janë njësoj, çka është dëshmi se kur ato drejtohen nga një staf profesional dhe me kualifikimin e duhur, janë efikase dhe i shërbejnë vërtet vendit. Ndryshe është rasti, kur drejtohen nga militantë apo njerëz të pakualifikuar, si rastet që kemi denoncuar. Nuk do të themi se cilat seli diplomatike konsiderojmë efikase, për të mos bërë që të humbasim (nga ndonjë "revansh" i mundshëm) edhe atë komunikim të rrallë institucional, që e kemi si ujët e pakët, jo për fajin tonë sigurisht. Do të mjaftohemi të përmendim rastet negative, duke shpresuar që kritika të shërbejë sadopak për përmirësimin e punës së tyre.

Nisur nga një shkrim i publikuar në portalet online³ se një informaticien që punonte në

³ Artikull, dyshime për emërimin si Konsull në Janinë të një informaticieni
<http://www.syri.net/2016/04/12/komandanti-i-jugut-tani-edhe-pasha-i-janines-kokedhima-emeron-drejtorin-grek-te-kompanise-se-tij-konsull-te-shqiperise-ne-janine/>

biznesin e një ish-deputeti shqiptar ishte emëruar Konsull në Janinë, nisëm të bënim verifikimet e nevojshme për një gjë të tillë, por kontakti me Konsullatën shqiptare në Janinë prodhoi një situatë komike, që nxjerr në pah edhe një herë paqartësitë dhe shërbimin e gabuar apo të munguar ndaj qytetarëve shqiptarë nga ana e shërbimit të jashtëm. Përballë kërkesës së thjeshtë nga ana jonë për të na informuar lidhur me emrat e Konsullit të Përgjithshëm dhe të Konsujve, Konsullata e Republikës së Shqipërisë në Janinë na dha një përgjigje në limitet e absurdit në kontaktin që patëm me të në rrjetin social Facebook, në faqen zyrtare të Konsullatës. Konsullata na bëri me dije, se bazuar te një urdhër i ministrit të Jashtëm Z. Ditmir Bushati, autoriteti kompetent për dhënien e informacioneve zyrtare për publikun në Ministrinë e Punëve të Jashtme na qenka "vetëm Koordinatori për të drejtën e informimit, në Autoritetin Publik MPJ (pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore)".

Së pari ne kërkuam një informacion të thjeshtë, nuk kërkuam një shkresë zyrtare, me vulë, datë dhe firmë. Përgjigja e Konsullatës në fjalë, është njësoj si të shkosh të pyesësh në një qendër të urgjencës shëndetësore se cili është drejtori dhe të të adresojnë në Ministrinë e Shëndetësisë, apo të pyesësh në një komisarjat se cili është shefi dhe të të thonë se duhet të shkosh në Ministrinë e Brendshme për të marrë një informacion kaq të "çmuar". Sipas kësaj logjike, çdo qytetar shqiptar që dëshiron të marrë një informacion nga Konsullata, duhet t'i drejtohet MPJ-së. Atëherë cili është kuptimi i hapjes së një Konsullate në një vend të huaj, kur për këto shërbime u dashka shkuar vetëm në Tiranë? Apo ndoshta Konsullata nuk e di se cilët janë drejtuesit e saj? Deri në provë të kundërt, barra e provës bie mbi të.

Që ky është një gabim dhe mungesë profesionalizmi nga ana e Konsullatës, këtë e dëshmon edhe fakti se me përfaqësi të tjera diplomatike (si duket pak me më tepër përvojë së ajo e Janinës), nuk kemi hasur aspak në një pengesë dhe ngurtësi

të tillë në marrjen e informacionit. Madje edhe vetë stafi i ri i Konsullatës në Milano është treguar më i përgjegjshëm dhe rigoroz karshi nesh në këtë drejtim.

4- Greqia paska çliruar Shqipërinë (askush nuk e dinte!)

Kontaktet e shpeshta dhe bisedimet e shtruara në tryezë mes Shqipërisë dhe Greqisë janë mjaft pozitive. Falë procesit integruar të Shqipërisë në BE, jemi në një fazë kyçe⁴, ku ndërmjet dy vendeve mund të zgjidhen probleme historike të mbartura prej shumë dekadash. Por bie në sy një element që mund të krijojë pengesa të reja dhe të pakapërcyeshme mes palëve, përjashtoj ndonjë zemërgjerësi të mundshme, si ajo që u bë dhe u zhbë me çështjen e paktit detar nga qeverisja e kaluar dhe gjykata Kushtetuese. Greqia pretendon se në Shqipëri kanë rënë 11.000 ushtarë të saj⁵, gjatë një viti të vetëm, atij 1949-1941, gjatë luftës italo-greke, një pjesë e së cilës u zhvillua edhe në territorin shqiptar.

Në historiografinë shqiptare ka mjaft debat edhe për numrin e të rënëve shqiptarë, me pretendimin se 25,000 dëshmorët e deklaruar zyrtarisht gjatë luftës së dytë botërore, kanë qenë një shifër e fryrë nga regjimi komunist. Tani rezulton se Greqia ka humbur thujtë sa gjysmën e dëshmorëve shqiptarë në një vit të vetëm. Sipas kësaj shifre, një deduksion logjik bën të mendohet se një meritë të mirë për çlirimin e Shqipërisë e ka pasur edhe ushtria greke me luftën e saj kundër fashistëve, gjë e cila ndoshta dëgjohet për herët e para nga anët tona.

Nga ana tjetër, nuk kuptohet përse Italia fashiste ngeci në malet e Shqipërisë, kur i

paska shkaktuar një dëm kaq të madh në numër palës kundërshtarë.⁶ Nuk kuptohet gjithashtu se si është arritur në një përfundim të tillë. A ka një komision të përbashkët shqiptaro-grek që ka rënë dakord për këtë shifër? Nëse jo a do ta pranojë si të mirëqene Shqipëria? Por mbi të gjitha, nëse varrezat greke pranohen, a do të vendosen ato në një mënyrë të barabartë dhe simbolike, si varrezat e ushtarëve gjermanë dhe britanikë në Tiranë, apo do të lejohet që në mënyrë demonstrative dhe në forma mauzolesh madhështore të vendosen në Jugun e Shqipërisë, të cilin qarqet ekstremiste greke e konsiderojnë si Vorio Epir, dhe ku përhapja e ortodoksisë greke me synime asimiluese nëpërmjet kishës ortodokse shqiptare të drejtuar nga një grek, dhënies së pensioneve (për minoritarët dhe jo vetëm) dhe shkollave nuk është e vogël?

Këto pikëpyetje mund të marrin ndoshta një përgjigje më të qartë gjatë takimit të radhës në Tiranë Bushati-Kotzias, por në rast se për shifrën e të rënëve grekë dhe për vendin e vendosjes së varrezave nuk do të ketë debat, kjo padyshim do të bënte që Athina zyrtare jo për herë të parë të përfaqëonte një pretendim të "megallo-idesë" dhe të përpiqej ta zbatonte atë në Shqipëri, pas hasur asnjë pengesë.

Gjithashtu, shifra e fryrë e të rënëve grekë duhet parë edhe në optikën e direkte të negociatave. Ajo mund të jetë rritur qëllimisht për t'u përdorur si një gur shkëmbimi, në mënyrë që çdo lëshim i mundshëm grek, të konsiderohet nga pala helene si një koncesion, duke ulur kështu për rrjedhojë edhe fuqinë negociuese të Shqipërisë në pretendimet e saj në bisedimet dypalëshe.

⁴ Takim i ri Bushati-Kotzias në Tiranë, problemi me varrezat greke <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=327663&fundit>

⁵ Pretendimet greke për numrin e të rënëve në Shqipëri në vitin 1940-1941 <http://www.panorama.com.al/vizita-zbardhet-paketa-e-propozimeve-te-ministrit-grek-per-shqiperine/>

⁶ Arben Puto, Diktatore dhe Kuislinge Lufta Italo-greke, Shtëpia Botuese Toena, 2011, faqe 50.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

ADELA DANAJ, MSc

1-“Pacient”, nuk është më kryefjala e Sistemit Shëndetësor Shqiptar...

Sot, Shqipëria ballafaqohet me një sistem shëndetësor kompleks dhe të dobët. Shërbimet shëndetësore sot mbështeten nën dy shtylla kryesore, kujdesin shëndetësor publik dhe atë privat. Megjithatë, ajo që lehtësisht tërheq vëmendjen është cilësia e ulët e shërbimit shëndetësor publik dhe kosto e lartë financiare e shërbimit shëndetësor privat. Është shqetësues fakti që sistemi shëndetësor shqiptar, dominohet nga kultura e varfër civile dhe mungesa e informacionit të pacientit. Përgjithësisht, në momentin që qytetarët ballafaqohen me një shqetësim shëndetësor apo një kërkesë urgjente shëndetësore, ata nuk janë në gjendje të zgjedhin se ku duhet të shkojnë dhe cilin trajtim duhet të ndjekin. Fatkeqësia më e madhe është se ata nuk njohin diferencë midis shërbimeve shëndetësore, ndaj janë të detyruar të pranojnë dhe të binden ndaj asaj çfare ofrohet në “tregun” mjekësor.

Në kushtet në të cilat gjendet sistemi shëndetësor në Shqipëri, mjekët janë krejtësisht indiferentë, megjithëse është domosdoshmëri mbrojtja e pacientëve. Megjithatë, në rastet kur Urdhri i Mjekut ka “ngritur zërin” mbi çështje apo problematika të caktuara, nuk ka pasur asnjë feedback pozitiv. Këto dhe shumë arsye të tjera, kanë sjellë të ashtu-quajturin liberalizimin e sistemit shëndetësor dhe spitalet private janë një nga format më dominante të kësaj forme të re organizimi në sistemin mjekësor shqiptar.

Në të njëjtën kohë, monitorimi dhe kontrolli mbi sektorin shëndetësor privat nga institucionet shtetërore është bërë më i vështirë dhe komplikuar. Sipas

specialistëve apo rasteve të cilat raportohen në media, spitalet private ofrojnë shërbim të dobët shëndetësor dhe kosto shumë të lartë. Rastet jo të suksesshme që kanë ndodhur nuk kanë qenë në qendër të inspektimeve të institucioneve shtetërore përgjegjëse, duke lehtësuar punën e këtyre spitaleve dhe vështirësuar jetën e pacienteve.

Në këto kushte, në Shkurt të viti 2015, Banka Botërore, aprovoi fondin prej 31.1 milion Euro, në kuadër të Projektit për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor në Shqipëri, projekt ky që do të vinte në bashkëpunim me qeverinë Shqiptare¹.

Shqipëria i është bashkuar Bankës Botërore në vitin 1991 dhe që nga ajo kohë janë nënshkruar rreth 84 projekte duke kapur vlerën e 2.1 miliard dollar, të cilat u janë dhuruar shtetit tonë nëpërmjet fondeve IDA dhe IBRD. Banka Botërore, si një partner i fuqishëm dhe i besueshëm, nuk ka arritur ende të ndryshojë apo përmirësojë kushtet në sistemin shëndetësor shqiptar. Mungesa e vullnetit politik si dhe aferat korruptive, nuk lejojnë hapjen e shtigjeve të reja dhe përmirësimin e kushteve primitive në sektorin mjekësor shqiptar. Për ti ardhur në ndihmë këtij konstatimi, mjafton të ndjekim median dhe ato çfarë raportohen aty. Jo më larg se më 12 Maj, gazeta Panorama denoncon rastin e 6 pacientëve që vuanin nga HIV/AIDS, të cilët humbën jetën si rezultat i mungesës së ilaçeve në pavijonin e infektivit në Qendrën Spitalore Nënë Tereza në Tiranë².

Ndërkohë, jo më larg se një muaj më parë, APPA, raportoi nëpërmjet raportit të muajit

¹ World Bank
<http://www.worldbank.org/en/nees/press-release/2015/02/27/world-bank-to-help-improve-quality-access-and-efficiency-of-albanias-health-care-system> aksesuar për herë të fundit më 28 Maj 2016

² Gazeta Panorama
<http://www.panorama.com.al/mungesa-e-ilaceve-opozita-akuza-beqajt-kane-humbur-jeten-6-paciente-me-sida/> aksesuar për herë të fundit më 28 Maj 2016

prill, fenomenin e mungesës së medikamenteve bazike në spitale³.

Për t'ju rikthyer edhe një herë fenomenit të liberalizimit të sistemit mjekësor, mbetet ende e paqartë dhe gjithmonë e më shumë dyshuese liria absolute e këtyre veprimtarive private, të cilat më shumë ngjasojnë me agjenci biznesi se sa agjentë në shërbim shëndetësor. Domosdoshmëria për të ngritur një strukturë funksionale në këtë sistem është emergjente. Sot, më shumë se kurrë, Shqipërisë i duhet: (i) Implementimi i strategjive si dhe politikave të cilat përmirësojnë shërbimin shëndetësor në sektorin publik; (ii) Forcimi i kapaciteteve menaxheriale të institucioneve shëndetësore përmes implementimit të modeleve bashkëkohore në menaxhimin shëndetësor duke garantuar në këtë mënyrë që do të jetë "pacienti" në krye dhe kryefjala e sistemit shëndetësor shqiptar.

2-Një qendër konsulte për të shmangur radhët e gjata

Një nga lajmet e arritjeve të Ministrisë së Shëndetësisë, ndër të tjera është dhe lajmi mbi ngritjen e një qendre të konsultës ambulatorie pranë QSUT-ës⁴. Në përrurimin e kësaj qendre, ishte i pranishëm dhe Kryeministri i vendit, Edi Rama. Kjo qendër do të jetë në shërbim vetëm për ata pacientë të cilët do të kërkojnë shërbim mjekësor në lidhje me sëmundjet e brendshme dhe kirurgjikale. Qëllimi i krijimit të saj, (eveniment për sistemin shëndetësor shqiptar, domosdoshmëri absolute në çdo vend të botës, mungesa e së cilës rithekson dhe një herë gjendjen e mjerueshme në të cilën ndodhet mjekësia

në Shqipëri), është për të shmangur radhët e gjata nëpër sportele. Ky është argumenti që ka ngritur faqja zyrtare e Ministrisë së Shëndetësisë në artikulin e detajuar të lajmit në fjalë.

Në fakt, qendrat e konsultës ambulatorie, të cilat dikur mirë funksiononin në Shqipëri në çdo zonë të populluar, janë dyert e para ku duhet të trokasë çdo qytetar në momentin që ballafaqohet me një problem shëndetësor. Qëllimi parësor i tyre është të japë ndihmën e parë për njerëzit që kërkojnë ndihmë shëndetësore si dhe të diagnostikojë çdo pacient duke dhënë ose jo rekomandimin për vizitë më të detajuar në spital. Në rast se në Shqipëri, këto lloj qendrash do të funksiononin, atëherë nuk do të ishin shpenzuar 110 milionë lekët, që shkuan në ngritjen e qendrës së konsultës në QSUT, ku ndër të tjera, ashtu sikurse u përmend dhe më lart, vendi i saj nuk është në QSUT, por në çdo zonë të banuar me qytetarë shqiptar. Në një sistem të ngritur mirë, sigurisht që do të shmangeshin radhët e gjata, megjithëse kam frikë se dhe në këtë rast argumenti nuk qëndron, pasi qëllimi në vetvete nuk duhet të jetë shmangia e radhëve, por shërbimi cilësor me mjetet e duhura dhe në kohën e duhur.

³ APPA Think Tank <http://appa.al/raport-prill-2016-ministria-e-shendetesise/> aksesuar për herë të fundit më 28 Maj 2016

⁴ Ministria e Shëndetësisë <http://www.shendetesia.gov.al/al/neesroom/lajme/qender-moderne-e-konsultes-ambulatorie-ne-qsut&page=1> aksesuar për herë të fundit më 25 Maj 2016

MINISTRIA E SHTETIT PËR ÇËSHTJET VENDORE

Mirilda TILI, BA

1- Reformën territoriale e "bëjmë" por ligjin nuk e zbatojmë

Nuk themi asnjë gjë të re, nëse ministritë pa portofol duhet të mbyllën sepse në ditën e tyre të punës nuk regjistrojnë asnjë aktivitet. Nuk është përjashtim nga rregulli as Ministria e Shtetit të Çështjeve Vendore. Për muajin maj, zyrtarisht shënon vetëm një pjesëmarrje të organizuar nga Këshilli i Europës. Në konferencën kombëtare "Reformat në Qeverisjen Vendore dhe Administratën Publike - Mundësi të Reja për Administratën Publike", organizuar sot nga Këshilli i Europës, Ministri i Çështjeve Vendore, Ministri i Inovacionit dhe Administratës Publike, dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim u diskutuan arritjet e reformave në qeverisjen vendore dhe administratën vendore, si edhe sfidat dhe mundësitë e administratës vendore në vijim të fuqizimit të strukturave të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri. Në këtë konferencë morën pjesë ekspertë dhe donatorë me kontribut të veçantë në qeverisjen vendore dhe administratën publike si dhe përfaqësues të nivelit të lartë të Qeverisë Shqiptare, bashkitë, qarqet dhe organizatat ndërkombëtare.¹ Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, z. Bledi Çuçi gjatë fjalës së tij i bëri thirrje pushtetit vendor që të bëjë të gjitha përpjekjet për të çuar përpara zbatimin e reformës territoriale

¹ Pasqyrim aktiviteti

<http://www.ceshtjetvendore.gov.al/al/neesroom/deklarata-per-shtyp/konferenca-kombetare-reformat-ne-qeverisjen-vendore-dhe-administraten-publike>

dhe asaj të decentralizimit, për të rritur performancën e ushtrimit të përgjegjësive të tyre në të njëjtën qasje dhe vizion që po ecën qeveria. Deri këtu duket sikur gjithçka shkon mirë. Por nëse i referohemi asaj se çfarë po ndodh konkretisht shohim që reforma territoriale nuk po zbaton një nga prioritetet e saj, siç është ligji i ri për Informimin Publik.² Ligji i ri "Për të Drejtën e Informimit" nuk gjeti zbatim të menjëhershëm në nivel të qeverisjes vendore për shkak të RAT. Ai ishte i kushtëzuar objektivisht të fillonte pas bërjes efektive të ndarjes së re admisnitrativo-territoriale, praktikisht pas Zgjedhjeve Vendore të 21 Qershorit 2015. Konstituimi i organeve të reja vendore përfundoi në Korrik-Shtator 2015, ose rreth një vit pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri "Për të Drejtën e Informimit". Me konstituimin e organeve drejtuese në Bashki, ri-filloi edhe ecja e afateve për caktimin e koordinatorëve të të drejtës së informimit dhe adoptimin e programeve institucionale të transparencës. Nëse për institucionet e tjera afati ligjor për marrjen e masave për implementimin e Ligjit për të Drejtën e Informimit skadonte në 3 maj 2015, për bashkitë e reja të krijuara, me analogji, ai skadon në datë 3 maj 2016...

² Studimi i publikuar <http://www.infocip.org/al/ep-content/uploads/2016/05/RTI-implementation-albania-2016-Final-sëeden-OPC.pdf>

MINISTRIA E SHTETIT PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

Mirilda TILI, BA

1- Kanë filluar pushimet

U bënë disa muaj rresht që APPA denoncon faktin që ministrinë pa portofol nuk bëjnë asnjë detyrë për të cilën të justifikojnë rrogat që marrin nga taksat e qytetarëve. Gjatë muajit maj kjo ministri vetëm ka marrë pjesë në aktivitetin e organizuar nga Këshilli i Europës. Në këtë aktivitet ministrja Milena Harito është shprehur: "Qendra që po inaugurojmë sot në çeljen e Javës së Inovacionit 2016, është një hapësirë dedikuar tërësisht të rinjve. Gjenezja e Godinës së Inovacionit në tërësi daton nëntorin e vitit 2013, kur ne sapo kishim marrë detyrën. Ishte ideja e Kryeministrit, që të krijojmë një hapësirë prestigjioze, një vend të veçantë ku të gjitha agjencitë e inovacionit, që atëherë ishin ende shumë të vogla dhe shumë të copëzuara të kishin një vend ku kryefjala e të gjithëve të ishte bashkëpunimi dhe shpejtësia. Sepse teknologjia vrapon dhe teknologjia nuk na pret. Në këto dy vite e gjysmë qeverisje, kemi më shumë se 4-fishuar investimet e shtetit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe kemi më tepër se 3-fishuar burimet njerëzore, sidomos në dy agjencitë më të mëdha që janë Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, që zë tashmë gjithë katin e parë të kësaj godine dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, agjenci që ishte pothuajse inekzistente përpara

2 vjetësh dhe tani ka rreth 40 punonjës. ASIG ka krijuar një hapësirë të madhe informacioni Gjeohapësinor që është baza e kadastrës së ardhshme të shtetit shqiptar"¹.

Edhe në këtë rast, kjo ministri mund të kishte kryer si një drejtori ose si një institucion i përbashkët mes dy ministrive asaj të Çështjeve Vendore dhe Inovacionit dhe Administratës Publike. Ky ishte një aktivitet i përbashkët, i ndjekur nga të dy këto ministri, por që në fakt asnjëra prej tyre nuk ishte organizatore.

¹ Pjesë nga fjalimi i ministres Harito në javën e teknologjisë

<http://www.inovacioni.gov.al/al/neesroom/lajme/celet-java-e-inovacionit-2016-me-perurimin-e-innovation-hub>

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

Endrit KAPAJ, LLM

1-Aksidentet rrugore, Shqipëria në gjendje lufte.

Muaji prill, shënoi mjaft aksidente me pasoja të rënda, duke përfshirë edhe humbje jete. Aksidenti tragjik i ndodhur në aksin rrugor Plepa-Rrogzhinë, ku humbën jetën dy fëmijë, si pasojë e prerjes së barrierave mbrojtëse të rrugës, shërbeu për të rikthyer vëmendjen e publikut tek siguria e qarkullimit në rrugë dhe sinjalistika rrugore. Në programin e Qeverisë Shqiptare 2013–2017, për sa i përket qarkullimit dhe sigurisë rrugore theksohet "...Rritja e sigurisë rrugore përbën gjithashtu një prioritet madhor. Kjo do të realizohet në tri ndërhyrje kryesore:

-në drejtim të përfundimit të veprave të papërfunduara sipas standardeve si dhe eliminimit të pikave të zeza të aksidenteve;

-forcimit të rregullave të qarkullimit rrugor dhe zbatimit të tyre pa kompromis;

-si dhe një fushatë ndërgjegjësuëse e edukative që fillon në bankat e shkollës.

Numri i aksidenteve rrugore synohet të ulet në masën 20%, vetëm gjatë vitit të parë të këtij mandati qeverisës.¹


¹ Qarkullimi dhe siguria rrugore

<http://www.transporti.gov.al/al/publikime/qarkullimi-dhe-siguria-rrugore/qarkullimi-dhe-siguria-rrugore>

Megjithatë, statistikat tregojnë një situatë tejet të përkeqësuar. Referuar INSTAT² përgjatë viteve të mandatit qeverisës, aksidentet rrugore jo vetëm që nuk janë ulur, por përkundrazi janë rritur. Për më në detaje tabela më poshtë:

Sipas vitit	Aksidente me dëmtime personi	Të dëmtuarit (vrrarë plagosur)	Nga të cilët: Të vdekur	Aksidente nën veprimin e alkoolit	Të dëmtuar	Nga të cilët: Të vdekur
2005	853	1.182	307	18	39	10
2006	1.015	1342	277	81	44	36
2007	1.254	1.728	384	59	51	20
2008	1.208	1.559	303	66	78	24
2009	1.465	1.833	378	108	141	28
2010	1.564	2.068	352	43	55	14
2011	1.876	2.472	322	16	25	5
2012	1.870	2.569	334	19	20	0
2013	2.075	2.798	295	37	49	7
2014	1.914	2.617	264	123	231	21
2015	1.992	2.692	270	98	160	17

E shprehur grafikisht tabela do të shfaqte këtë panoramë:



² Aksidente në Shqipëri

<http://www.instat.gov.al/al/themes/transp/orti.aspx>

Trendi rritës i aksidenteve nuk po ndalet, por kjo fatkeqësisht po shoqëron edhe rritjen e pasojave në jetë njerëzore. Mund të themi lirisht se politikat e qeverisë në këtë drejtim kanë dështuar dhe për këtë nuk mjafton vetëm kërkesa për dorëheqje ndaj Ministrit Haxhinasto, por një përgjegjësi tërësore e kësaj mazhorance si një premtim i pa mbajtur.

2-Porti i Durrësit, shteti dorëzim pa kushte tek koncesionarët.

Porti më i madh i vendit, prej kohësh lëngon nga situata problematike e krijuar ndërmjet shoqërisë koncesionare të Terminalit Lindor dhe shoqërive të tjera të licencuara që kryejnë veprimtarinë e ngarkim shkarkimit të anijeve. Kjo situatë problematike është shoqëruar me bllokim të anijeve në Port, duke rënduar financiarisht klientët dhe duke i detyruar ata jo vetëm që të mendojnë, por tashmë të zgjedhin porte të tjera të vendeve fqinje.

Gjatë këtij viti dhe atij në vazhdim në Portin e Durrësit do të shkarkohen tubat, të cilat do të instalohen për projektin TAP. Projekt, i cili konsiderohet madhor për ekonominë e vendit tonë, por duket se përfitimi i buxhetit të shtetit nga kryerja e këtij operacioni do të jetë minimal, për të mos thënë simbolik. E drejta për kryerjen e operacionit të shkarkimit të tubave të projektit TAP i është dhënë shoqërisë koncesionare EMS APO. Por ku qëndron problemi?

Autoriteti Portual Durrës zotëron të gjitha kapacitetet operacionale, njerëzore dhe teknike, për ta kryer këtë operacion në Terminalin nën administrimin e saj, duke angazhuar shoqëritë e licencuara të ngarkim-shkarkimit, por duket se interesi i autoritetit drejtues të APD ka qenë që këtë

operacion ta kryej koncesionari. Për këtë qëllim, shoqëria TAP është orientuar dhe këshilluar që operacionin ta kryejë nëpërmjet koncesionarit. Duket mjaft e dyshimtë që ky veprim nga ana e Drejtorit të APD të jetë kryer nisur nga interesi i cilësisë më të lartë, pasi siç e theksuam më lart APD zotëron të gjitha asetet e specializuara për përpunimin e mallrave të përgjithshme, ku hyjnë edhe tubat. Dyshimi bëhet edhe më i madh nëse analizon aspektin financiar të këtij operacioni, konkretisht: nëse operacioni do të kryhej në Terminalin nën administrim dhe menaxhim të saj APD do të përfitonte 55% të tarifës së shkarkimit, ndërkohë që tashmë ajo do të përfitojë vetëm 11% të tarifës. Faktet e mësipërme meritojnë vëmendjen e institucioneve përgjegjëse, veçanërisht të Kontrollit të Lartë të Shtetit

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGETISE DHE SIPERMARRJES

Gerion TRESKA, MSc

1- Kush fshihet pas gishtit të "investimeve të huaja"?

Stuhia që po përshkon ekonominë shqiptare megjithëse është fakt dhe të gjithë qytetarët e shikojnë dhe e ndjejnë sidomos në xhepat e tyre, duket se në sferën politike po trajtohet thjesht si një çështje e zakonshme aspak me rëndësinë e duhur. Eklipsimi i keqtrajtimit të kësaj çështjeve i dedikohet në mënyrë të veçantë Reformës në Drejtësi por njëkohësisht edhe një busulle që duket se tregon më së shumti drejtimin e gabuar.

Pavarësisht përpjekjeve për të formalizuar bizneset, qasja e ndjekur nga më i vogli tek më i madhi duket se ende vazhdon të shkaktojë reagime tek të vegjlit pasi tek të "mëdhenjtë" nuk dihet se kur do të mbërrijë. Le të mos harrojmë se jemi pranë fundit të mandatit të kësaj qeverie dhe koha nuk duket mjaft premtuese bazuar në këtë qasje për t'u marrë edhe me të "mëdhenjtë", mbase sepse kjo nuk është edhe fort në interes të politikës, të mos harrojmë kush i financon kryesisht fushatat respektive.

Me statistika më shumë dekurajuese se sa inkurajuese, ku vetëm në vitin 2015 u regjistruan pothuajse 3 herë më shumë çështje për falimentim të kompanive krahasuar me vitin 2014, më saktësisht në 2015 çështjet për faliment të regjistruara në Gjykatën e Shkallës së Parë ishin 64 përkundrajt 22 çështjeve në 2014¹. Vlen të

¹ Rritet me trefish numri i kompanive për faliment - <http://acp.al/news/2176/Gjykata-e-Tiranes,-ne-2015-en-u-trefishua-numri-i-falimenteve-te-kompanive/>

përmendet se në këtë listë bëjnë pjesë biznese të mëdha si Kurum, Albanian Airlines, Volalba, Italcrom etj. Por në anën tjetër kemi edhe një biznes më të formalizuar për të cilin e gjithë qeveria përpiqet të marrë lavdet por që nuk po jep ende rezultat.

Guri i parafundit i shahut që po luhet për të nxitur ekonominë shqiptare është varësia e tejskajshme për investime të huaja direkte. Marrëveshje pas marrëveshjeje MZHETTS dhe vetë Kryeministri përpiqen të promovojnë Shqipërinë si një partner të sigurtë dhe nxitës për bizneset dhe investitorët e huaj. Me gjithë dritat e alarmit të ngritura nga Trupat Diplomatik vendas për përkeqësimin e situatës ekonomike, rritjen e riskut si dhe të nivelit të korrupsionit, askush nuk duket të reagojë denjësisht mbi këto zëra.

Fakt është se investitorët serioz dhe ata më të besueshëm po largohen dhe po e heqin vëmendjen nga Shqipëria, në veçanti ata kinez, duke i lënë vend investitorëve pasues të cilët kryesisht nuk kanë një emër të mirë në fushën e biznesit. Po përse duhet të ndodhë kjo situatë në një vend ku Kryeministri gjatë Konferencës "Reforma në Ekonomi dhe klima e biznesit" është shprehur se informaliteti i biznesit është ulur ndjeshëm? Madje po në të njëjtën Konferencë ai shprehet se me anë të reformave të qeverisë u shpëtua falimenti i shumë kompanive dhe se konkurrenca në biznesin shqiptar po fillon të funksionojë.

Me gjithë optimizmin e Kryeministrit duket sikur përfaqësuesi i Bankës Botërore në Shqipëri nuk e mendon kaq të lulëzuar situatën e ekonomisë Shqiptare. Dhe sipas qëndrimit të këtij institucioni, Shqipërisë do t'i duhen disa dekada për të arritur standardet europiane të ekonomisë, duke filluar që nga rritja ekonomike prej 4.5%. Pavarësisht vlerësimit për hapat e ndërmarrë nga qeveria, sërish vëmendja mbetet tek niveli më i ulët i investimeve të

huaja në Shqipëri krahasuar me vendet e Ballkanit².

Debatit mbi çështjen e investimeve të huaja direkte i është bashkuar edhe Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s i cili sjell lajmin se në 5 muajt e fundit kanë qenë 96 kompani të huaja që kanë kërkuar informacion nga AIDA për të investuar në vendin tonë³. Por ky informacion nuk jep asnjë tablo apo të dhënë mbi natyrën ose besueshmërinë e këtyre investitorëve.

Mbas gishtit të investimeve të huaja është e qartë se po fshihen shumë palë dhe institucione kryesisht qeveritare, por ky duket një qëndrim krejt kundër rrymës së realitetit që po ndodh jashtë zyrave të administratës qeveritare. Ajo çka është akoma më e vështirë për t'u pranuar nuk është ikja e investitorëve por varësia ndaj fondeve të huaja për të zhvilluar ekonominë vendase.

2- Ekonomia Shqiptare në dorë të investimeve publike!

Mbingarkimi prej reformave të ndërmarra nga qeveria po i imponon në mënyrë të vazhdueshme një ritëm disi çorientues klimës së biznesit me ndryshime të paparashikueshme në rregullore dhe rregulla. Ky është mesazhi që vjen nga Zëvendës-Shefi i Misionit të Ambasadës së SHBA në Tiranë i cili i bashkohet shumë zërave të ngritur edhe nga përfaqësitë e tjera diplomatike në vendin tonë⁴.

Duke theksuar më së shumti vështirësitë që hasin jo vetëm kompanitë amerikane

² Konferenca "Reforma në Ekonomi dhe klima e biznesit" - <http://acp.al/news/2209/Rama:-Reformat,-te-lidhura-me-ekonomine%3b-jo-takse-te-sheshte/>

³ AIDA konfirmon interesimin e kompanive të huaja në Shqipëri - <http://www.balkanweb.com/site/drejtori-i-aida-ne-news24-96-kompani-te-huaja-kane-kerkuar-informacion-per-te-investuar-ne-shqiperi/>

⁴ Intervistë e David Muniz - <http://albanian.tirana.usembassy.gov/latest-embassy-news/2016-deklarata/interviste-e-david-muniz-zevendes-shefi-i-misionit-te-ambasades-se-shba-ne-tirane-me-gazeten-panorama-4-maj-2016.html>

por edhe ato të tjera ndërkombëtare në zbatimin e kontratave, vendimet e gjykatave si dhe korrupsionin Zëvendës-Shefi i Misionit të Ambasadës së SHBA në Tiranë shprehet se këto janë elementë kyç të cilët patjetër ndikojnë në atraktivitetin e vendit për të zhvilluar biznes.

Këtij shqetësimi ndërkombëtar po t'i shtojmë edhe deklaratën e Ministrit Ahmetaj se ka një rënie të madhe të konsumit publik, jo atij privat dhe pikërisht ky ka qenë qëllimi që Qeveria të mos ketë pjesën e luanit në konsum futemi në një rreth vicioz i cili na kthen gjithnjë në pikën e fillimit. Statistikat jo vetëm të INSTAT por edhe ato të EUROSTAT tregojnë qartë se ka një rënie të konsumit jo vetëm publik por edhe atij privat. Dhe si të mos mjaftojë kjo bizneset dhe individët ndjehen të pasigurtë për të ardhurat e tyre. Sipas Reporter.al⁵ problemi shtesë është se qeveria po vijon të mos shpenzojë dhe ka gjasa, do të vijojë të mos shpenzojë edhe për këtë vit

Në fakt kjo situatë është trishtuese dhe vërteton se ekonomia shqiptare po mbahet vetëm nga dy burime:

- Investimet publike, të cilat janë me pikatore,
- Investimet e huaja direkte, të cilat po zbehen ato të duhurat duke i lënë vend investitorëve më të pasigurtë.

Ajo çka duket qartë në këtë situatë është se qeveria ndodhet në një ngërç për ta bërë ekonominë vendase tërheqëse për investitorë të huaj serioz dhe të besueshëm. Dhe që të mbushë këtë "gabim" përpiqet që herë pas here të kryejë shpenzime publike në formën e injeksioneve të vogla "sa për të mbajtur frymën" ekonomia e vendit. Në këtë mënyrë tenderat bëhen akoma më joshës

⁵ Lehtësimi sasior mund të mbërrijë në Shqipëri - <http://www.reporter.al/lehtesimi-sasior-politika-qe-mund-te-mberrije-ne-shqiperi/>

duke nxitur informalitetin dhe abuzimin me procedurat dhe jo vetëm, fakte të cilat janë treguar në kohë jo vetëm nga kjo qeveri por edhe nga të tjerat.

Në përfundim ajo çka vret ekonominë vendase duket se është faktori plotësisht "made in Albania", politika që prodhojmë dhe modeli i gabuar që ndjekim si ekonomi, nëse ende mund të quhet e tillë. Një vend i cili mbahet ose përmes parave të të huajve ose injeksioneve qeveritare tregon qartë që brenda veten nuk përmban pothuajse asgjë prodhuese për të ardhmen.

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Mimi BARUSHI, MSc

1- Sfidat e strehimit social.

Ministria e Zhvillimit Urban ka ndryshuar disa nga rregullat për zbatimin e programit të banesave me kosto të ulët. Në një udhëzim të ministres së Zhvillimit Urban, Eglantina Gjermani, përcaktohet se qytetarët përfitues do të kenë vetëm një muaj kohë për të lidhur kontratën.

Nëse qytetari (familja) i/e miratuar me vendim të këshillit bashkiak përkatës, nuk paraqitet për/ose nuk pranon lidhjen e kontratës brenda një periudhe kohore 1-mujore (njëmujore) nga njoftimi i kryer nga EKB-ja, ky i fundit i drejtohet për zëvendësimin e këtij qytetari Këshillit Bashkiak, i cili përcakton një qytetar tjetër për t'u trajtuar me strehim në këtë apartament.

Në rast se këshilli bashkiak përkatës, brenda një periudhe kohore 5-mujore, nuk bën zëvendësimin me një familje tjetër përfituese, EKB-ja me vendim të Këshillit Drejtues të institucionit, pas miratimit nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, shet apartamentin në tregun e lirë¹.

Siç flasin vetë të dhënat zyrtare, Ministria e Zhvillimit Urban kishte planifikuar 165 familje të komunitetit rom me kushte banimi të përmirësuara për 3 mujorin e parë të këtij viti. Rezultati është zero. Ministria ka planifikuar gjithashtu 151 banesa të ndërtuara para vitit 1993 të

¹ Banesat sociale, ndryshojnë rregullat për afatet dhe kështet: <http://ëëë.gazetadita.al/banesat-sociale-ndryshojne-rregullat-per-afatet-dhe-kestet/>

rehabilituara. Edhe këtu, rezultati është zero. Dikasteri i drejtuar nga Eglantina Gjermani kishte planifikuar për 3 mujorin e parë 176 familje që trajtohen me qera financiare. Nga këto rezultojnë të jenë trajtuar vetëm 57 familje. E njëjta situatë vijon dhe me ndërtimin e banesave të reja sociale. Të dhënat flasin se Ministria e Zhvillimit Urban kishte planifikuar për 3 mujorin e parë të merrte 6 mijë m² sipërfaqe ndërtimi për banesat sociale me qira. Për këtë periudhë rezultojnë të jetë marrë vetëm afro një e treta e planit, ose 1970 m².

Ministria kishte parashikuar të ndihmonte për të njëjtën periudhë 20 familje një-prindërore/gra të divorcuara me fëmijë që përfitojnë bonus strehimi. Sipas të dhënave të disponuara nga ministria e Gjermanit, rezultojnë se për 3 mujorin e parë nuk është ndihmuar asnjë familje e tillë. Po ashtu, parashikimet flisin për ndihmesën e 525 familjeve me bonus qeraje për strehimin. Në të vërtetë asnjë prej këtyre familjeve nuk është ndihmuar, siç tregojnë shifrat për 3 mujorin. Ndërsa me grante të menjëhershme për strehimin do të ndihmoheshin 17 familje, të cilat në fakt nuk e morën kurrë këtë përfitim².

2- Të investosh në Shqipëri?

Një planifikim më i mirë urban mund ta kthejë Shqipërinë në një vend më konkurrues, me një ekonomi më efikase, e cila i hap rrugën realizimit të investimeve të suksesshme, vendase dhe të huaja. Vendi ynë mbart shumë potenciale zhvillimi në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë.

² Qeveria dështon me planifikimin për strehimin social, nuk përmirësohen kushtet e familjeve rome dhe egjiptiane, braktisen gratë e divorcuara dhe jetimët - <http://ëëë.sot.com.al/ekonomia/qeveria-d%C3%ABshton-me-planifikimin-p%C3%ABr-strehimin-social-nuk-p%C3%ABrmir%C3%ABsohen-kushtet-e-familjeve#sthash.2MKXMcPD.dpuf>

Këto potenciale kanë nevojë për një miradministrim në mënyrë që çdo investim i kryer të jetë i qëndrueshëm, i besueshëm dhe të gjenerojë të ardhura afatgjatë për investitorin dhe ekonominë e vendit³ - tha në fjalën e saj, konferencën me titull "Të investosh në Shqipëri: Sfida dhe mundësi" ministria Gjermani.

Ndërkohë që ministria përmend përpjekjet dhe hapat e ndërmarra nga Qeveria në garantimin e një zhvillimi të mirplanifikuar të territorit, bizneset e huaja kanë paralajmëruar se nëse nuk përmirësohet klima e biznesit në vend, ata do të fokusohen në vende të tjera në Europë dhe botë. Biznesi i huaj vazhdon të ketë kusht miratimin e Reformës në Drejtësi për të investuar në Shqipëri dhe qasjet e MZHU-së janë minimale në këtë radhë.

³ Të investosh në shqipëri:

<https://www.facebook.com/media/set/?set=a.597563027085459.1073741916.210244069150692&type=3>